

ALI DHRIMO

FORMIMI I MBIEMRAVE NË GJUHËN E SOTME SHQIPE *

Mbiemri është një nga klasat më të pasura. Kjo pjesë e ligjëratës është pasuruar e po pasurohet vazhdimisht me fjalë të reja, qoftë nga pjesë të tjera të ligjëratës, qoftë nga vetë klasa e mbiemrave.

Vëzhgimet e para, të shkurtëra po jo pa interes, rreth formimit të mbiemrave i gjejmë në veprën e J. Georg fon Hanit¹. Aty jepet formimi i mbiemrave me anë të prapashtesave *-të, -im* ose *-m, -rë* (i vjetërë) dhe *-isht*. Mbiemrat e formuar nga ndajfoljet me prapashtesën *-m* dhe me paranyjëzim interpretohen si formime nga parafjalët. Hani shpreh i pari edhe pikëpamjen e gabuar se «në kompozitat e rralla me emrat mbiemri qëndron herë *para* e herë *prapa*»² (nënvizimet janë bërë prej meje — A. Dh.). Që këto kompozita nuk janë aspak të rralla në gjuhën shqipe, këtë e ka argumentuar bindshëm A. Kostallari³. Në pohimin tjetër që mbiemri në këto kompozita mund të qëndrojë edhe përpara emrit, Hanin e ka çuar një keqinterpretim i materialit — mbiemrin *sypishë* që në të folmet jugore, ku e ka mbledhur Hani, dëgjohet *sipishë*, ai e ka zbërthyer në *zi-pishë*.

Një radhë vërejtjesh e shënimesh rreth formimit të mbiemrave gjejmë edhe te vepra e italoarbëreshit Dh. Kamarda⁴. Përveç prapashtesave që përmend Hani, Kamarda shton edhe *-shmë, -tar, -tor* dhe *-tuar* (*tuer*). Ai trajton diçka më gjerë edhe kompozitat mbiemërore dhe, megjithëse është kontradiktor, arrin në përfundimin se «janë mjaft të shumta e mund të krijohen me lehtësi»⁵.

Një trajtim të mirë e më të gjerë gjen formimi i mbiemrave nga një tjetër italoarbëresh, Xhuzepe De Rada⁶. Aty shprehet sëpari mendimi se mbiemrat e shqipes, ndryshe nga të latinishtes e të greqishtes, formohen prej ndajfoljeve përkatëse me anë të paranyjëzimit. Dallohen

*) Punimi është pjesë e monografisë së plotë mbi mbiemrat, hartuar në vitin 1966, dhe është azhurnuar e plotësuar vetëm pjesërisht me material e botime të mëvonshme.

1) J. Georg von Hahn, *Beiträge zu einer Grammatik des toskischen Dialektes, Alb. Studien*, Heft II, Jena, 1854, 44 v.

2) Po aty, 45.

3) A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, BUSHT, SShSh, 3/1961, 3-25. Shih edhe kritikën që i bëhet atje pikëpamjes së mësipërme të Hanit, f. 5-6.

4) Dh. Kamarda, *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorno, 1864.

5) Po aty, 208.

6) Giuseppe De Rada, *Grammatica della lingua albanese*, Firenze, 1870.

mbiemra të formuar nga: 1) ndajfolje, 2) emra dhe 3) folje (*gënjetar*). Nga kompozitat dallohen ato që formohen nga: 1) *emër + mbiemër*, 2) *emër + emër*, 3) *folje e shtjellë + emër* (*haeshtra = eshtrangrënës*), 4) me *as-* dhe *pa-* (edhe këto të fundit shikohen gabimisht si kompozita). Vihet në dukje se mbiemrat e përbërë dhe mbiemrat foljorë (*gënjetar*) nuk marrin nyjë të përparme. Aty përmenden edhe këto prapashtesa diminutive: *-th, -z, -aq, -uq* e *-ush*.

Të mprehta e të sistemuara më mirë janë vërejtjet e A. Dozonit⁷. Dozoni formimin e mbiemrave nuk e trajton veçan, por ka një kapitull mjaft të gjerë mbi fjalëformimin, ku ndër të tjera flitet edhe për formimin e mbiemrave. Mjaft prapashtesa që janë të përbashkta për formimet emërore e mbiemërore, Dozoni i jep vetëm për të parat (*-ar, -tar, -ak, -ik, -ok, -as, -ës (és)*). Nga prapashtesat që formojnë mbiemra, përmenden: *-t, -m, -çim* e *-içt*; nga prapashtesat jepen *pa-* e *për*⁸.

Autori i parë vendas dhe që depërtoi me sukses në thelbin e strukturës morfologjike të mbiemrit, qe K. Kristoforidhi⁹. Në gramatikën e K. Kristoforidhit trajtohen mbiemrat e prejardhur nga 1) ndajfoljet, duke marrë në fund një *(-ë)* («*i shpeshë, i kotë*») («po kështu formohen, — nënvizon ai, — edhe *i bardhë, i bukurë... i mirë, i urtë...*»); nga ndajfoljet e prapashtesa *(-m)* («*i nesërm*»); 2) *emrat* («*i artë, i fisëm*»); 3) *foljet* («*i hapëtë*»); 4) *pjesoret* («*i pëlqyershim -i pëlqyeshim, i mbyllur*»); 5) *abstraktët* («*i ngeshim*»). Trajtohen edhe mbiemrat e prejardhur nga emrat dhe pjesorja me pjesëzën mohuese *pa-* («*i padukur*», «*i pabesë*»), dhe mbiemrat që nuk dallojnë nga emrat («*shkodëran*»).

Një plotësim e thellim të rëndësishëm i bëri studimit të mbiemrit (këtu edhe formimit të tij) S. Frashëri¹⁰. Veç vërejtjeve të parashkuesve, Samiu dallon edhe ndarjen e mbiemrave në mbiemra të nyjshëm e të panyjshëm; dallon te mbiemrat edhe «fjalë më vetëhe» (të parme); vëren se gjithë «përgjysmoret» (pjesoret) janë mbiemra; te formimi i mbiemrave me prapashtesat *-shm, -shim, -m, të a -çim* thekson edhe rolin fjalëformues të nyjës së përparme. Mbiemrat e përbërë i quan «të ngjitura» e thekson që këta «s'marrinë kurrë nyje».

Në kapitullin kushtuar fjalëformimit, Gj. Pekmezi, në gramatikën e vet¹¹, trajton shkurt edhe disa nga prapashtesat që formojnë mbiemra (*-shëm, -çëm, -m, -të* edhe *-ën* (tosk. *-ër*). Te kompozimi, formime të tilla si *ditëbardhë, ditëzi, faqebardhë, faqezi, dorështrënguar, kurrizdalë* etj. shikohen gabimisht si «substantive»¹². Mendon se pa nyjë mbiemrat janë ndajfolje» (*mirë, fort*) dhe «për shkak të theksit të fjalisë ato mund të jenë shkurtuar në krahasim me mbiemrat¹³.

G. Vaigandi¹⁴ mendon me të drejtë se prapashtesa më e shpeshtë në formimin e mbiemrave është prapashtesa *-shëm* («e cila mund të ketë

7) A. Dozon, *Manual de la langue chkiye ou albanaise*, Paris, 1879.

8) Për të gjitha këto shih: Po aty, 273, 275, 277, 280, 282-283. Për pikëpamjet e gabuara të A. Dozonit lidhur me kompozitat e shqipes (f. 285v.), shih hollësisht analizën kritike të A. Kostallarit në art. e cit., f. 7-8, 9, 15.

9) K. Kristoforidhi, *Grammatiki tis Alvaniq's Glossis*, Konstantinopojë, 1882. Për sa u tha më sipër, shih: f. 25-26-27-28-29.

10) S. Frashëri, *Shkronjëtoe e gjuhës shqip*, Bukuresht, 1886, 37-28.

11) Gj. Pekmezi, *Grammatik der albanesischen Sprache*, Wien, 1908.

12) Po aty, 227-228.

13) Po aty, 104.

14) G. Weigand, *Albanesische Grammatik*, Leipzig, 1913, 53-54-55.

jë vetëm kuptim pësor, por edhe vepror»). Pas prapashtesës *-shëm*, më e shpeshta shikohet prapashtesa *-(ë)m* (meqë ai merr për bazë dialektin geg). Përmenden edhe formimet me prapashtesën *-t* (nga tema emërore e foljore) dhe *ur* (f. *or*) nga lat. *orius*. Vaigandi mendon se ndajfoljet cilësore e të mënyrës janë sekondare e mbiemrat përgjegjës primarë.

Mjaft gjërë e ka tratjuar formimin e mbiemrave edhe I. D. Sheperi¹⁵. Në kapitullin «Prejardhja» studjohet veçmas formimi i mbiemrave me anë të nyjës së përparme nga a) pjesoret e b) ndajfoljet. Thuhet se mbiemrat vijnë nga a) emrat ose mbiemrat, b) foljet dhe c) ndajfoljet. Nga emrat formohen mbiemra të nyjshëm me prapashtesat *-shëm* a *-ëm* dhe *t(ë)*. Jepen edhe dy «mbiemra zvogëlimi i vogëlth, e voglëzë». Aty theksohet se mbiemrat e prejardhur nga foljet janë mbiemra pjesorë (ose pjesore të nyjshme) dhe mbiemra foljorë dhe se nga të parët «fort të pakta pjesore mund të përdoren edhe me kuptim vepëror, të tjerat kanë kuptim pësor». «Mbiemrat foljorë marrin prapashtesën *-shëm* (ose *-ëm*) dhe tregojnë atë që mund ose meriton të pësojë». Edhe tipi i *hapët* trajtohet si i prejardhur nga folja. Formimet nga ndajfoljet trajtohen si të prejardhura a) vetëm me anën e nyjes së përparme («i mirë»), b) me nyjë e me prapashtesat *-shëm* a *-ëm* dhe *-t(ë)*. Edhe Sheperi formimet mbiemërore të tipit: *emër + mbiemër* (a pjesore), *ndajfolje + mbiemër* dhe *numëror + emër* i quan pëngjitime¹⁶.

Në «Librin e gjuhës shqipe» të A. Xhuvanit gjejmë për herë të parë një përkufizim të mbiemrave «të parshëm», «kur janë të thjeshtë e nuk kanë dalë prej ndonjë tjetër fjale», të mbiemrave «të prejardhur, kur kanë dalë prej ndonjë tjetër fjalë» dhe të mbiemrave, «të përngjitur, kur janë bamë prej dy fjalësh bashkë»¹⁷.

Duke njohur po ato rrugë formimi për mbiemrat si edhe paraardhësit (sidomos Sheperi), O. Myderrizi në «Gramatikën e re të shqipes» ka bërë përpjekje për një sistemim më të mirë e për nxjerrje rregullash të përgjithshme dhe ka dhënë një numër më të madh prapashtesash që formojnë mbiemra, sesa paraardhësit e tij (*-ë*, *-t(ët)*, *-shëm*, *-m*, *-r*, *-osh*, *-s*, *-ës*, *-njës*; *-ar*; *-tar*, *-uer*, *-tuer*, *-uk*, *-ik* e *-aq*)¹⁸.

Shkurt është trajtuar formimi i mbiemrave në kapitullin përkatës të «Gramatikës shqipe»¹⁹ të K. Cipo. Por duke e parë trajtimin e fjalëformimit në tërë veprën, kuadri plotësohet mjaft mirë edhe për formimin e mbiemrave. Është me interes të shënohet se në kapitullin e prapashtesave K. Cipoja dallon: «Prapashtesa mjeshtërie, profesioni, zejtarie, nëpunësie: *-tar*, *-ar*, *-ës*, *-ist*, *-ik*, *-tor*. Prapashtesa banorësh: *-ar*, *-it*, *-as*, *-an*; *-ak*; *-njan*, *at*, *-a-rak*. Prapashtesa veglash: *-ës* (shtypës) Prapashtesa *emrash pejorativë* që tregojnë një të metë trupore: *-ash*, *-osh*, *-ac*, *-njar*, *-rash*, *-a-cak*, *-a-njos*, *-ec*, *-ok*»²⁰. Pra të gjitha këto prapashtesa Cipoja i njuh si prapashtesa që formojnë *emra*. Që Cipoja e njuh përdorimin e fjalëve të prejardhura me këto prapashtesa (ose të një pjese të tyre) edhe si mbiemra, për këtë nuk ka asnjë pikë dyshimi,

15) I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927.

16) Për të gjitha këto shih: Po aty, 135-136-137, 141.

17) A. Xhuvani, *Libri i gjuhës shqipe*, 1938, 53. A. Xhuvani i jep këto përkufizime për fjalët e parme, të prejardhura e të përngjitura qysh më 1920 në librin e vet me të njëjtin titull, por për mbiemrin jepen sëpari më 1938.

18) O. Myderrizi, *Gramatika e re e shqipes*, Tiranë, 1944, 78-79.

19) K. Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949, 77-78; 39-40-41-42-43-44-45.

20) Po aty, 41-42.

por besoj se ai me të drejtë është i mendimit që përdorimi primar i këtyre fjalëve është si emra, prandaj ka përmendur vetëm këtë.

Një trajtim të mirë ka gjetur formimi i mbiemrave në kapitullin mbi fjalëformimin në veprën e autorit të huaj L. Njumark²¹. Për pjesën më të mirë të prapashtesave që përmenden, jepet edhe denduria e përdorimit dhe prodhimtaria e tyre. Aty dallohen nga njëri-tjetri formimet thjesht mbiemërore nga ato që përdoren edhe si emra edhe si mbiemra. Trajtohen edhe formimet me parashtesën *pa-*²².

Ndryshe nga paraardhësit e studjon formimin e mbiemrave Sh. Demiraj në tekstin për studentët e degës së gjuhës shqipe të Fakultetit të historisë dhe të filologjisë²³. Ai vështron në radhë të parë jo temat prodhuese, por mjetet formale: prapashtesat e parashtesat, me të cilat formohen mbiemrat e ndryshëm (ky kriter thyhet deridiku nga paragrafi: *Mbiemra të formuar nga pjesoret me anë të nyjeve të përparme*). Në këtë tekst bëhet një analizë e hollësishme (me aq sa lejojnë caqet e një teksti) e mbiemrave të formuar me prapashtesa, me parashtesa, e atyre që formohen nga pjesorja dhe e atyre që janë të përbërë (megjithëse për këta të fundit, sipas formulimit të bërë nga autori, lihet shteg për të menduar se nuk janë aq të shumtë në gjuhën shqipe²⁴, kurse në të vërtetë përbërja është një nga mënyrat më prodhimtare në formimin e mbiemrave).

Një kontribut mjaft të vlefshëm në studimin e mbiemrave të përbërë sjellin dy artikujt e A. Kostallari: «Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe» dhe «Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese»²⁵. Këtu analizohet hollësisht vjetërsia e prodhimtaria e madhe e fjalëve të përbëra në gjuhën shqipe, hidhen poshtë pikëpamjet e disa autorëve të huaj (Han, Dozon e Vaigand) që ky tip nuk ekziston ose është pak prodhimtar në gjuhën shqipe. Njëkohësisht në këta artikuj trajtohen edhe çështje të karakterit teorik që kanë të bëjnë me këtë tip fjalëformimi.

Përveç këtyre trajtimeve të formimit të mbiemrave, bërë nëpër grammatikat e ndryshme të shqipes ose në punime kushtuar mbiemrave, aspekte të veçanta të tij gjejmë edhe nëpër trajtime të tjera që nuk lidhen drejtpërdrejt me këtë çështje. Një listë parashtesash e prapashtesash ka dhënë edhe D. N. Gazulli në fillim të fjalorit të tij²⁶. Në këtë listë mungon çdo shtresëzim i këtyre formanteve fjalëformuese: nuk bëhet as ndonjë dallim midis planit sinkronik e diakronik, as përmendet se ç'pjesë ligjërata formohen me to. Kjo listë në përgjithësi është e paplotë, kurse veçanërisht për mbiemrat është pothuajse krejt e varfër.

Duke u marrë me sufiksin diminutiv të emrave në gjuhën shqipe, V. Dançetoviq ka trajtuar në një masë pak a shumë të gjerë formimet

21) L. Newmark, *Structural Grammar of Albanian*, Bloomington, 1957.

22) Po aty, 45-46-47-48-49.

23) Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, I, Tiranë, 1960, 82-85.

24) Po aty: «Në gjuhën shqipe ka edhe një numër mbiemrash, që janë fjalë të përbëra (kompozita)» — (nënvizimi është bërë prej meje — A. Dh.).

25) A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, BUSHT, SShSh, 3/1961, 3-20; idem, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, BUSHT, SShSh, 3/1962, 3-45; shih edhe kumtesën e tij: *Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes*, në «Konferencën I të Studimeve albanologjike», Tiranë 1965, 166-167.

26) D. N. Gazulli, *Fjalorth i ri — fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipnis*, Tiranë 1942.

prapashtesore emërore në gjuhën shqipe²⁷. Ky punim është me interes edhe për mbiemrat, sepse autori shpreh herëpashere disa mendime lidhur me formimin e tyre prapashtesor. Ai mendon se «disa sufiksa të gjuhës shqipe i japin fjalës kuptim të dyfishtë edhe si emën edhe si mbiemën. Në raste t'atilla, asht gja e natyrshme, do të ndalem ma hollësisht në emnin, ndërsa kuptimin e kategorisë së dytë të fjalës sall do ta përmendi». Së pari do vënë në dukje që në raste të tilla nuk kemi të bëjmë me të njëjtën fjalë që ndryshon vetëm në planin gramatikor (herë emër e herë mbiemër), por, siç do të shihet më tej, me dy fjalë leksikisht e gramatikisht të ndryshme. Së dyti këtu nuk formohet gjithmonë edhe emri edhe mbiemri me të njëjtën rrugë: me anë të prapashtesimit, por shpeshherë i pari me prapashtesim, i dyti me konversion. Ajo që ka interes këtu është pikëpamja e drejtë e autorit për të quajtur si kategori të parë kategorinë emërore e si të dytë kategorinë mbiemërore. Kjo pikëpamje mbështetet pothuaj gjatë gjithë studimit të tij; kështu aty jepen si emra: *barkalik* (f. 10,50), *vocërrak-u*, *vocërrake-ja* (f. 11), *bardhok* (f. 11), *burrac*, *burracak* (f. 23), *shurdhac*, *përtac*, *dorac* (f. 29), *frigac*, *frikac*, *frikaç* (f. 30), *thumbac*; *thumbec*; *burravec* (f. 31), *mburravec*, *hunded*, *burrec*, *bythec*, *barkalec* (f. 33), *durrsak*, *romak*, *ulqinak* (f. 47), *shtatanik* *shtrembanik* (f. 50), *shkurtaliq*, *shkurtalaq*, *thatiq* (f. 65), *kuqalash*, *kuqalosh* (f. 69), *morrash*, *pordhash*, *gojash* (f. 70), *thimash*, *verdash*, *vjedharash* (f. 71).

Autori shpreh mendimin se «asht i rrallë sufiksi diminutiv i emnave në gjuhën shqipe, i cili nuk ka mundësi të japi dhe kuptim mbiemner» (f. 21). Megjithatë qëndrimi i autorit nuk del gjithmonë i qartë lidhur me këtë çështje, sepse nga ana tjetër ai thotë: «të gjithë mbiemrat e panyjshëm në gjuhën shqipe mund të kenë paralelisht funksionin dhe kuptimin e emnit, mbiemnit e shpesh edhe të ndajfoljes» (f. 11). Pra lidhur me derivacionin autori nuk është shprehur gjithmonë qartë se si e mendon, cila nga këto dy pjesë ligjërata është primare e cila sekondare.

Një kontribut shumë të vlefshëm për studimin e fjalëformimit të gjuhës shqipe në përgjithësi e rrjedhimisht edhe në studimin e formimit të mbiemrave kanë dhënë edhe dy studimet e bëra nga A. Xhuvani e E. Çabej mbi parashtesat²⁸ dhe prapashtesat²⁹ e gjuhës shqipe. Meqë këto dy studime janë nga më të fundit e më të rëndësishmet në këtë lëmë, janë pasur parasysht vazhdimisht e në mënyrë të veçantë në trajtimin e këtyre çështjeve (më hollësisht për secilën prej tyre shih: § 2.1 v. dhe § 2.2 v.).

Nga gjithë ky parashtrim i gjendjes së studimeve del se formimi i mbiemrave ka filluar të trajtohet relativisht herët në gramatologjinë shqipe, qysh në tekstet më të hershme. Trajtimi i tij ka ardhur vazhdimisht duke u zgjeruar e duke u thelluar. Vëmendja e studjuesve është përqëndruar më tepër në trajtimin e formimeve parashtesore dhe prapashtesore të mbiemrave. Megjithatë edhe këtu vërehen një numër boshllëqesh e keqinterpretimesh që kërkojnë një saktësim të mëtejshëm.

27) V. Dançetoviq, *Sufiksi diminutiv i emnave të gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1960 (Përkth. nga serbokroatishtja: A. Çetta).

28) Prof. Dr. A. Xhuvani — Prof. E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, BUSHT, SShSh, 4/1956. (Më tej: Parashtesat).

29) Prof. A. Xhuvani — Prof. E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë 1962. (Më tej: Prapashtesat).

Në një masë më pak të mjaftueshme janë trajtuar tipet e tjera të fjalëformimit të mbiemrave, bile ndonjëra ka mbetur pa u trajtuar fare, si p.sh. formimi me anë të konversionit dhe disa nga tipet e përbërjes. Nga ana tjetër, në krahasim me studimin gramatikor shumë prapa ka mbetur trajtimi leksikosemantik i mbiemrave. Përveç punimeve të lartpërmendura të A. Kostallarit, vetëm tani vonë ka dalë një trajtim i shkurtër e i pjesshëm leksikosemantik për mbiemrat foljorë të formuar me prapashtesën *-shëm*³⁰.

* * *

Shqyrtimi i mbiemrave sipas strukturës së tyre formale (të njëshëm e të panyjshëm) është bërë gjetiu³¹, prandaj në këtë punim do të shqyrtohen mbiemrat vetëm për nga struktura e tyre fjalëformuese.

Tipet më prodhimtare të fjalëformimit për mbiemrat janë *prejardhja* (afiksimi, paranyjzimi, paranyjzimi e afiksimi njëkohësisht), *konversioni* dhe *përbërja*. Klasa e mbiemrave është pasuruar edhe me anë të huazimit nga gjuhët e tjera. Krahas mbiemrave që formohen në rrugë të ndryshme, në gjuhën shqipe ka edhe një varg mbiemrash të parmë.

1. Mbiemra të parmë.

Mbiemrat, të cilëve në planin e shqipes së sotme nuk mund t'u hetohet as tema prodhuese, as ndonjë formant fjalëformues, quhen mbiemra të parmë. Pra, ata mbiemra që nga pikëpamja e fjalëformimit janë të pazbërthyeshëm në elementët e tyre përbërës dhe nuk janë të prejardhur nga ndonjë pjesë tjetër e ligjëratës, janë fjalë të parme. Kështu del plotësisht i drejtë pohimi i A. Xhuvanit që «emrat e mbiemrat quhen të parshëm, kur janë të thjeshtë e nuk kanë dalë prej ndonjë tjetër fjale»³².

Është bërë traditë, që nga S. Frashëri e deri tek Sh. Demiraj, të theksohet se «të paka miemëra janë vetiu fjalë më vetëhe»³³, që «numri i mbiemrave, që janë fjalë të para, në gjuhën shqipe është mjaft i kufizuar»³⁴, e O. Myderrizi arrin në ekstremitet, duke pohuar se «mbiemrat cilësorë në shqipe përveç nja tre a katërve që janë të parmë janë të gjithë të prejardhur a të përngjitur»³⁵. Në qoftë se vërejtja e dy të parëve është e drejtë në planin e morfologjisë historike, dhe për fazën e atëhershme të zhvillimit të gjuhës shqipe, në planin e sotëm dalin mjaft mbiemra, për strukturën e të cilëve nuk mund të jepet dot shpjegim. Prandaj është më e drejtë të thuhet se shqipja ka një varg mbiemrash të parmë. Duke ia kundërvënë vargut të mbiemrave të prejardhur e të përbërë, natyrisht, ky varg është relativisht i kufizuar në numër. Të tillë mbiemra janë *i bardhë*, *i keq*, *i lig*, *i mirë*, *i shëndoshë*, *i verdhë*,

30) P. Haxhillazi, *Vëzhgime mbi mbiemrat foljorë me prapashtesën -shëm në gjuhën shqipe*, në SF, 2/1969, 145-162).

31) Shih: A. Dhrimo, *Mbi disa çështje të klasifikimit morfologjik të mbiemrave në shqipen e sotme letrare*, në SF, 1/1969, 49v.

32) A. Xhuvani, *vep. e cit.*, 53.

33) S. Frashëri, *vep. e cit.*, 37.

34) Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, I, 82.

35) O. Myderrizi, *vep. e cit.* 74.

i zi etj. Në grupin e mbiemrave të përmendur edhe ata mbiemra që janë quajtur forma reliktoze të mbiemrave sot në nyjshëm³⁶. Paranyjëzimi i mëvonshëm i këtyre formave fillestare të mbiemrave të shqipes nuk ndryshoi asgjë në kategorinë e tyre mbiemërore, vetëm se i bëri edhe formalisht të dallueshme prej të njëjtave forma të përdorura në funksion ndajfoljor, prandaj mendoj se si format e tipit *shëndoshë*, ashtu edhe format e nyjshme *i shëndoshë* janë barabar mbiemra të përmendur.

Nga ana tjetër, në shqipen e sotme ka edhe mjaft mbiemra të huazuar nga gjuhë të ndryshme, por që janë bërë pjesë e fondit aktiv të gjuhës shqipe (kh. mbiemra të tipit *absurd, absolut, abstrakt, aktual, normal, relativ* etj. etj.). Lind pyetja: Ç'qëndrim do të mbahet ndaj tyre lidhur me analizën fjalëformuese? Mendoj se nuk mund të vazhdohet rruga e deritanishme duke i mbajtur këta mbiemra thjesht si të huaj e duke mos hyrë në analizën e tyre fjalëformuese, përderisa këta po futen gjithmonë e më thellë në gjuhën e gjallë. Por, nga ana tjetër, edhe po të duam t'i analizojmë, njohuritë tona nuk mund të jenë gjithmonë të mjaftueshme për të shqyrtuar strukturën e këtyre mbiemrave në planin bashkëkohor, sa kohë që këta kanë hyrë në gjuhën shqipe jo vetëm nga disa gjuhë por edhe në kohë të ndryshme. Prandaj, për mendimin tim, mbiemra të tillë, të cilët, megjithëse për ta është botërisht e njohur gurra e huaj, janë bërë element i pazëvendësueshëm i fondit aktiv të shqipes, morfologjikisht duhet të trajtohen si mbiemra të përmendur, sa kohë që në gjuhën shqipe nuk ka çifte (a më tepër se çifte) fjalësh që të lejojnë hetimin e fjalës prodhuese bazë (derivuese) dhe fjalës së prodhuar (së derivuar) mbiemër. Rrjedhimisht mbiemrat e tipit: *all, bajat, banal, batall, biond, direkt, dekadent, elegant, elektoral, pedant* etj. në planin e gjuhës së sotme letrare, duhet të merren mbiemra të përmendur, pa hyrë në konsiderata etimologjike.

2. Mbiemra të prejardhur.

Mbiemrave të prejardhur mund t'u hetohet burimi në planin e shqipes së sotme; ata kanë rrjedhur nga fjalë të tjera me anë formantesh të ndryshme fjalëformuese.

Në këtë grup mbiemrash dallohen këto nëntipe: 1) Mbiemra të prejardhur me anë të parashtesimit; 2) mbiemra të prejardhur me anë të prapashtesimit; 3) mbiemra të prejardhur me anë të paranyjëzimit e prapashtesimit njëherazi; 4) mbiemra të prejardhura me anë të paranyjëzimit, parashtesimit e prapashtesimit njëherazi dhe 5) mbiemra të prejardhur me anë të paranyjëzimit.

2. 1. Mbiemra të prejardhur me anë të parashtesimit

Ky tip fjalëformimi i mbiemrave ka mbetur pothuajse pa u përmendur fare në gramatikat tona deri tek ribotimi nga Sh. Demiraj i dispensës së tij në vitin 1960³⁷. Po në këtë vit trajtohen mbiemrat e for-

36) Shih hollësisht, A. Dhërmo, *art. i cit.*, 58v.

37) Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 83. I pari G. De Rada, *vep. e cit.*, 48, përmend te kompozitat edhe formimet me *as-* e *pa-* (Ato me *as-*, në të vërtetë me *s-*, janë for-

muar me anë të parashtesimit nga P. Elezi — L. Dodbiba³⁸. Ndërtimi i disa mbiemrave me anë parashtesash është trajtuar, siç u tha më sipër, në vitin 1956 në «Parashtesat e gjuhës shqipe» nga A. Xhuvani — E. Çabej³⁹ (me parashtesat *a-*, *korro-*, *m-*, *mbi-*, *mos-*, *n-*, *nën-*, *ndër-*, *pa-*, *para-*, *pas-*, *për-*, *prapa-*, *që-*, *rë-*, *s-*, *stër-*, *tej-*). Autorët kanë dhënë një kontribut shumë të çmuar në këtë drejtim. Megjithatë, për shkak të destinacionit të vetë punimit, këta autorë nuk kanë dalluar parashtesat e shqipes së sotme nga ato që hetohen vetëm etimologjikisht; nga ana tjetër, nuk janë kapur të gjitha parashtesat që formojnë mbiemra, e, më në fund, ka aty shpeshherë ngatërresa midis mbiemrave të formuar me parashtesa dhe atyre të formuar me prapashtesa, por nga një pjesë tjetër e ligjëratës që ka si element përbërës të saj një parashtesë. Ne do ta përmendim qëndrimin e tyre për rastet e ndryshme në vendin përkatës. Pra me gjithë këto trajtime problemi mbetet i pastudjuar deri në fund, sepse ndërsa Sh. Demiraj i njuh shqipes vetëm një parashtesë mbiemërformuese (*pa-*), të dytët, pa i trajtuar gjithashtu të gjitha parashtesat mbiemërore, e shtrijnë këtë tip fjalëformimi të mbiemrave edhe në disa raste, ku në fakt nuk kemi të bëjmë me mbiemra të prejardhur me parashtesa, por me mbiemra prejpjesorë, me mbiemra të formuar me anë të prapashtesimit, ose me mbiemra të formuar me parashtesa që hetohen vetëm në planin e morfologjisë historike, por jo në atë të morfologjisë së sotme.

Edhe këtu del i njëjti problem si tek mbiemrat e parmë: shumë parashtesa me origjinë të huaj, përderisa janë bërë element i dallueshëm nga shqipfolësi tek mbiemrat përkatës, e bile nga modeli i huaj, analogjikisht, mund të kenë filluar të bëhen prodhimtare edhe brenda lëmit të shqipes, ne do t'i analizojmë si parashtesa mbiemërformuese brenda shqipes, pavarësisht nga origjina e tyre e huaj.

Karakteristike për parashtesimin është kjo, që si tema prodhuese shërbejnë kryesisht tema mbiemërore, kurse formimet nga tema emërore janë mjaft të rralla. Nga ana tjetër, mbiemri i formuar me anë të parashtesave ka po atë strukturë formale që ka edhe mbiemri përgjegjës pa parashtesë, pra nëqoftëse mbiemri që shërben si temë prodhuese, është i panyjshëm, atëhere edhe mbiemri i prejardhur prej tij me anë të një parashtese është i panyjshëm, përkundrazi, nëqoftëse mbiemri që

mime nga paranyjëzimi i pjesores: *i sdredhur*). A. Dozoni, *vep. e cit.*, 282-283, përmend formimet me *pa-* e *për-* (Rastet me *për-* që janë dhënë atje, janë formime me paranyjëzim, përngjitje e prapashtesim togfjalëshash: *i përditçm*, *i përnatçm*). K. Kristoforidhi, *vep. e cit.*, 29, përmend formimet me parashtesën *pa-*. O. Myderrizi, *vep. e cit.*, 79, 80, përmend formimet me «parafjalën» *pa-* dhe *për-* (shembujt ilustrues për këtë të fundit nuk qëndrojnë, ashtu si te Dozoni). K. Cipoja, *vep. e cit.*, 28, në paragrafin mbi parashtesat, te parashtesa *ndër-* shënon edhe mbiemrin *ndërkombëtar*. L. Njumark, *vep. e cit.* 40 e 49, përmend formimet me parashtesën *pa-*. Edhe Sh. Demiraj në veprën e cituar më lart (sikurse shtjellohet edhe në këtë punim) i njuh shqipes vetëm parashtesën *pa-* si formuese mbiemrash, por të paktën e ka mëvetësuar këtë tip fjalëformimi nga tipet e tjera, duke e nxjerrë si paragraf veçan.

38) P. Elezi — L. Dodbiba, *Gramatika e gjuhës shqipe — Fonetika. Morfologjia*, Tiranë 1960, 146.

39) Prof. Dr. Aleksandër Xhuvani — Prof. E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, BUSHT, SShSh, 4/1956.

shërben si temë prodhuese, është i nyjshëm, atëhere edhe mbiemri i preardhur me anë të një prapashtese është i nyjshëm.

Për lehtësi studimi, parashtesat mbiemërformuese do të renditen këtu jo sipas dendurisë e prodhimtarisë më të madhe apo më të vogël të tyre në gjuhën shqipe (gjë që është mjaft e përshtatshme për tekstet mësimore), por thjesht alfabetikisht, duke bërë vërejtjet përkatëse për secilën, si përsa i përket dendurisë ashtu edhe për prodhimtarinë e tyre (pra si përsa i përket faktit a janë formuar shumë fjalë me të apo vetëm raste të izoluar, ashtu edhe përsa i përket faktit tjetër: a ekziston edhe sot e gjithë ditën mundësia për formime të reja, apo kemi të bëjmë me raste të fosilizuara që nuk shërbejnë më si modele të gjalla fjalëformimi).

1. Një parashtesë relativisht e re e shqipes së shkruar është parashtesa me origjinë greke (a-), e cila ka funksion mohues, përjashtues. Kjo parashtesë është karakteristike kryesisht për gjuhën e shkrimit. Megjithëse mbiemrat e formuar me këtë parashtesë janë marrë drejtpërsëdrejti prej gjuhëve neolatine (kh. *apolitik*, *ateist*, *anormal*, *aton*), prapëseprapë ata janë të analizueshëm përsa i përket kësaj parashtese e, siç vërejnë me të drejtë A. Xhuvani dhe E. Çabej, kjo ka filluar të bëhet prodhimtare edhe në ndonjë fjalë shqipe si te *afetar*⁴⁰. Kh. ai është *anormal* — M. Kallamata, I fundit, 202).

Shënim: Mbiemri *aton* nuk ka për temë prodhuese një temë mbiemërore, por një temë emërore *ton-i*.

2. Një parashtesë tjetër me origjinë greke, e cila sa vete e po bëhet më prodhimtare në shqipen e sotme letrare, është parashtesa (anti-). Mbiemrat e formuar me këtë parashtesë kanë kuptim kundërshtimi a kundërvënjeje dhe janë: *antiajror*, *antifetar*, *anti amerikan*, *antifashist*, *antiimperialist*, *antikombëtar*, *antimalarik*, *antiparti*, *antipopullor*, *antipushtet antishkencor*, *antituberkular* etj. (p.sh. planet e tyre agresive *antiarabe* — Bashkimi, 15.III.1972, 4; veprimtaria e tyre *antiparti* e *antipushtet* — ZP, 1961).

Me këtë parashtesë nga pikëpamja e morfomës bazë, janë formuar kryesisht mbiemra prej temash mbiemërore, por në ndonjë rast edhe prej temash emërore (*antiparti*, *antipushtet*).

Shënim. Te mbiemri *kundërajëror* kemi shqipërimin e prapashtesës *anti-* ndërsa te *kundërrevolucionar* kemi shqipërimin nga gjuhët neolatine të krejt fjalës (kh. it. *controrivoluzionario*, fr. *contre-revolutionnaire*).

3. Një parashtesë pak prodhimtare është edhe parashtesa e lashtë shqipe (ç-). Kjo parashtesë sipas A. Xhuvanit dhe E. Çabejt u ngjitet disa foljeve; duke u dhënë kuptim antonimi» e «disa foljeve, duke u dhënë një kuptim faktitiv ose intensiv»⁴¹. Por kjo u ngjitet edhe disa mbiemrave duke formuar antonimet e tyre. Kjo përdoret si e tillë ose për arësye fonetike alernohet me *zh-* e *sh-*, p.sh. *çnjerezor*, *i çrregullt*, *i zhdrejtë*, *i shndershëm* e ndonjë tjetër. Megjithëse në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954 (67, 550) jepet folja *çkujdesem* (*shkujdesur*), besoj se mbiemri *i shkujdesur* është formuar më fort për analogji me raste të tjera sesa nga pjesorja e kësaj foljeje, e cila pothuajse nuk përdoret fare.

Duhet dalluar qartë mbiemrat e formuar me anë të kësaj parashtese nga mbiemrat prej pjesorë, ku parashtesa ç- është pjesë përbërëse e foljes përkatëse dhe nuk formon mbiemrin (kh. *i çenjtur*, *i çmobilizuar*,

40) A. Xhuvani — E. Çabej, *vep. e cit.*, 68.

41) *Po aty*, 70.

i shfryrë, i shkëputur, i shprishur etj. — të gjithë mbiemra të formuar nga paranyjëzimi i pjesoreve përkatëse).

Shënim: Parashtesat *an-* e greqishtes dhe *i-*, *im-* e *in-* të latinishtes nuk janë bërë aspak prodhimtare as në shqipen letrare. Mbiemrat që i përmbajnë këto parashtesa e që përdoren në gjuhën shqipe, janë marrë drejtpërsëdrejti prej gjuhësh të huaja (kh. *analfabet, ilegal, ireal, imoral, improduktiv, impersonal, impulsiv, indirekt, inorganik, intransitiv* etj.). Edhe kuptimi i këtyre mbiemrave është antonimik me atë të mbiemrave përgjegjës pa këto parashtesa.

4. Një vlerë parashtese po merr sa vete e më shumë edhe parafjala *jashtë-*, e cila, megjithëse ruan të pazbehur theksin e saj e deridiku edhe vlerën e saj leksikore, prapëseprapë ka prirje të qartë drejt kthimit në një parashtesë mbiemërformuese, ndonjëherë edhe ndajfoljeformuese, p.sh. *jashtëgjuhësor, jashtëshkollor, jashtëkohor, i jashtëligjshëm, i jashtëzakonshëm* etj. Mendoj se kështu duhet të shihen këta mbiemra në planin e sotëm, por në një vështrim jo aq motivus sesa thjesht fjalëformues, këta mbiemra duhen mbajtur ndoshta si të prejardhur me anë të paranyjëzimit, dhe përgjithësisht së togjeve *jashtë zakonit, jashtë ligjit*; ky i fundit mund të ketë ardhur edhe nëpërmjet kalkimit nga gjuhë të huaja.

5. Një parashtesë relativisht e re në formimin e mbiemrave është parashtesa *jo-*. Kjo parashtesë është plotësisht e njëvlerëshme me parashtesat *pa-* e *mos-*, ndryshimet midis tyre janë thjesht strukturore. Karakteristikë e saj është gjithashtu moszbehja e theksit, si të ishte fjalë e mëvetësishme, gjë që mund të linte shteg për vështrimin e fjalës ku kjo merr pjesë, si kompozitë e jo si fjalë e prejardhur me parashtesë, por duke parë edhe perspektivën e saj, sidomos tek mbiemrat e panyjshëm, kjo do të vështrohet si parashtesë. Me këtë parashtesë formohen mbiemra që janë antonimikë me mbiemrat përgjegjës pa parashtesë, p.sh. *zyrtar-jozyrtar, përparimtar-jopërparimtar, proletar-joproletar, kapitalist-jokapitalist, vëllazëor-jovëllazëror, homogjen-johomogjen, normal-jonormal* etj. Në formimin e mbiemrave kjo parashtesë, siç u tha më sipër, është relativisht e re dhe prodhimtaria e saj vjen duke u shtuar.

Te mbiemrat e nyjshëm pjesëza mohuese *jo*, nuk ka mundur të shndërrohet dot në parashtesë; po të ishte bërë e tillë, ajo do të ishte bërë pjesë përbërëse e trupit të mbiemrit, si mbarë parashtesat e tjera, kurse ajo qëndron e shkëputur para nyjes së përparme, p.sh. *jo i vogël, jo i zakonshëm, jo i rregullt, jo i sjellshëm, jo i hollë, jo i bukur* etj. Kjo vjen nga një kushtëzim strukturor; ndërsa mbiemrat e panyjshëm formohen nga përgjegjësit e tyre antonimikë vetëm me anë të parashtesave *jo-* e *mos-*, mbiemrat e nyjshëm formohen vetëm me anë të parashtesës *pa-* (shih më poshtë).

Shënim: Megjithëse ekzistojnë mbiemrat *korrovesh, korrobac, korropesh, korrozi*, përderisa nuk ekzistojnë të mëvetësishme të gjitha temat prodhuese (ekzistojnë *vesh* e *zi*, po s'ka temë *bac* e *pesh*) dhe sa kohë që edhe kuptimi i saj nuk është shumë i qartë, mendoj se pjesa e parë e këtyre fjalëve (*korro-*) mund të mos pranohet si parashtesë dhe këta mbiemra mund të shihen si fjalë të parme.

6. Një parashtesë, me të cilën, sipas vërejtjeve të A. Xhuvanit dhe E. Çabejt, «pas modelit të gjuhëve të huaja... janë formuar mjaft fjalë, kryesisht emra, folje dhe mbiemra, më fort të sferës abstrakte»⁴², është

42) A. Xhuvani — E. Çabej, *vep. e cit.*, 82.

parashtesa *mbi-*, e cila ka origjinë parafjalore, p.sh. *mbinjerëzor*, *i mbinatyrshëm**, *mbitokësor*, *mbiklasor* e ndonjë tjetër. Prodhimtaria e kësaj parashtese për sa u përket mbiemrave, është mjaft e kufizuar. Është për t'u vënë re se me këtë parashtesë formohet edhe ndonjë mbiemër nga një mbiemër tjetër prejpjesor, si p.sh. *i mbiemëruar* (<*i emëruar*), *i mbi-quajtur* (<*i quajtur*). Këtu nuk kemi mbiemra prejpjesorë nga pjesoret e foljeve *mbiemëroj*, *mbiquaj* (këto të dy folje ekzistojnë vetëm si mundësi potenciale e gjuhës e pikërisht për hir të një rindërtimi nga forma mbiemërore, kurse përdorim nuk kanë gjetur, por janë kalkime nga gjuhët neolatine — kh. fr. *surnommé*), p.sh. «Kodi i mirësjelljes» *i mbi-quajtur* edhe «Dekalogu i kryetarit» — Q. Buxheli, *Kariera*, 75; Në mes të tyre dallohet edhe nxënësja labovite Katua, e *mbiemëruar* Kato «shqip-tarja» — L. Dilo, *Lufta...*, AP, 1/1967, 81.

Shënim: Tek ndonjë autor gjejmë parashtesën *sipër-* në vend të parashtesës *mbi-* tek mbiemrat *sipërnjerëzor* (F. Noli, *Don Kishoti*, 12; *Hamleti*, 8, HeS, 113) dhe *sipërnatyror* (S. Papakristo, *Prometheu*, 11), por kjo ka mbetur e izoluar e nuk është bërë dot prodhimtare e bile as këta mbiemra nuk kanë gjetur përhapje.

7. Përdorimi i parashtesës *mos-* edhe si parashtesë për formimin e mbiemrave, me të njëjtën vlerë që kanë parashtesat *ç-*, *jo-* e *pa-*, ka mbetur i izoluar, p.sh. qeveria turke do të përdorë masat *mosnjerëzore*, (F. Postoli, L. e K., 157); nisë të përdorin mënyra *mos njerësore* (F. Postoli, *Për mprojtjen*, 109). Kjo parashtesë pothuajse nuk është aspak prodhimtare në formimin e mbiemrave, megjithatë, për analogji me emrat e vepruesit që me konversion kanë kaluar në mbiemra, janë formuar mbiemrat *mosmirënjohës*, *mospërfillës* dhe me një shtrirje më të kufizuar përdoret edhe mbiemri *moskokëçarës* (p.sh. pastaj ktheu kokën dhe pa me një vështrim *moskokëçarës* — J. Xoxa, *Lumi*, III, 209).

Shënim: Edhe parashtesa *nën-*, e cila sidomos në shqipen letrare është bërë mjaft prodhimtare në formimin e emrave dhe të foljeve — të shumtën e herës kalkuar nga gjuhë të huaja — për sa u përket mbiemrave ka mbetur e izoluar e krejt joprodhimtare. Mbiemrat *nëntokësor* dhe *i nëndheshëm* — cituar nga A. Xhuvani — E. Çabej si të prejardhur me këtë parashtesë (vep. e cit. 84), në të vërtetë nuk janë të tillë; ata formohen, siç do t'i shohim, me anë të prapashtesimit (i pari) dhe me anë të prapashtesimit e paranyjëzimit njëherazi (i dyti).

8. Parashtesa me origjinë parafjalore *ndër-* në gjuhën letrare shqipe haset vetëm në disa mbiemra që janë kalkuar nga gjuhët e huaja, si *ndërkombëtar*, *ndërluftues*, *ndërshtetëror*, *ndërsektorial* etj. Pra kjo parashtesë nuk është karakteristike për gjuhën popullore (kh. gjendjen *ndërkombëtare* — M. Kallamata, I fundit, 58; e rrangut *ndërkombëtar* — Q. Buxheli, *Kariera*, 7).

Pohimi se mbiemrat *i ndërmjemë*, *i ndërgjegjshëm*, *i ndërmjetshëm*, *i ndërkryem* a *i ndërkryer*, *ndërlidhës* e *ndërmjetës*⁴³. i ka formuar gjuhë e shkrimit me këtë parashtesë, siç do të shihet më poshtë, nuk qen-

*) është për t'u vënë në dukje që kuptimi i mbiemrit *i mbinatyrshëm* nuk del aq i qartë; ky formim nuk është aq i goditur; ndërtimi më i saktë është *mbinatyror*, p.sh. disa njerëz e kanë përqëndruar vëmëndjen tek një fuqi e *mbinatyrëshme* — ZP, 6.II.1964; ato i dukeshin si qenie të gjalla të pajisura me një fuqi *mbinatyrore*. — Dua të di, I, 48; mbetet vetëm fjalëza «interes» me një kuptim *mbinatyror* — V. I. Lenin, *Vepra*, 21, 240.

43) A. Xhuvani — E. Çabej, *po aty*, 85.

dron — këta mbiemra janë formuar nga një pjesë tjetër e ligjëratës me anë të prapashtesimit (dy të fundit) ose me anë të paranyjzimit (*i ndër-kryer*), ose me paranyjzim e prapashtesim (katër të parët), kurse *ndër-është* parashtesë për temat prodhuese dhe jo për mbiemrat e prejardhur prej tyre.

9. Parashtesa më prodhimtare për formimin e mbiemrave në gjuhën shqipe e veçanërisht në shqipen letrare, është parashtesa me origjinë parafjalore *pa-*. Me këtë parashtesë formohen mbiemra me funksion mohues, përjashtues prej mbiemrave të nyjshëm, p.sh. *i paafrueshëm*, *i pacaktueshëm*, *i pakundërshtueshëm*, *i palëkundshëm*, *i paardhur*, *i parrirë*, *i pabotuar*, *i padenjë*, *i padrejtë*, *i pafrikshëm*, *i pafuqishëm*, *i pangjarë*, *i pakufizuar*, *i pakufishëm*, *i palavdishëm*; *i paqenë*; *i pandershëm*, *i papastër*, *i pazellshëm* etj. Siç shihet, me këtë parashtesë formohen mbiemra që janë kuptimisht antonimikë me mbiemrat e formuar me anë të paranyjzimit të pjesores ose të paranyjzimit e prapashtesës *-shëm*, të cilët shërbejnë si tema prodhuese për mbiemrat e formuar me anë të parashtesës *pa-* (kh. *i anshëm*- *i paanshëm*, *i rregulluar*- *i parregulluar*). Unë nuk jam i mendimit të A. Xhuvanit e E. Çabejt që «gjuha e shkrimit me format në *-shëm* (*i pafuqishëm*, etj.) është larguar disi nga parimi formativ i shqipes në këtë pikë»⁴⁴, sepse mbiemrat e mësipërm me parashtesën *pa-* dhe prapashtesën *-shëm* në të vërtetë nuk duhen lidhur me prapashtesën. Ata, siç vërejtëm, nuk janë formuar në rrugën: *i pafuqi-shëm*, por *i fuqishëm* — *i pafuqishëm*, *i ndershëm* — *i pandershëm* etj. Nga ana tjetër, mbiemrat me *-shëm* janë mjaft popullorë në dialektin e veriut, kështu që *i ndershëm* — *i pandershëm* për këtë dialekt përbën një shfaqje krejt të rëndomtë dhe nuk duhet të jetë një dukuri karakteristike e gjuhës së shkrimit (kh. Merr një grue, qi kurrkund shopen s'e kishte: të mirë e të *ndershme* — D. Kurti, Përralla, 99; gjat vorrit t'asajë grueje së *ndershme* — po aty, 59; *i paa ndershim*, F. Blanchus: Ditionarium Latino-Epiroticum, 1635, 41; *i pā ndershm*, F. Rossi: Vocabolario Epirotico, I, 1886, 389, 744; n'ket mnnyr t'panneershme — Elçija i zemrës s'Krishtit, P. II, 1908, Nr. VIII, 119; Dora e mashet me Kanu quhet e *pandershme* — Kanuni i Lek Dukagjinit (Shtjefën Gjeçov), Hylli i Dritës, 1922, 241; vajza e juj asht ba e *panershme* — FSH I PP III 1966, 551 — shembujt me parashtesë janë marrë nga Kartoteka e leksikut të shqipes).

Për ndryshimin semantik midis *i paanë* dhe *i paanshëm* le të krahasohet: *det i paanë* dhe *njeri i paanshëm*, ku mbiemrat janë të pashkëmbyeshëm, si edhe vërejtjet tek prapashtesa *-shëm* dhe të formimet me paranyjzim.

10. Një parashtesë tjetër deri diku prodhimtare në lëmin e mbiemrave të prejardhur është parashtesa *para-*. Me këtë parashtesë me origjinë parafjalore formohen mbiemra nga tema mbiemërore e në ndonjë rast edhe nga një temë emërore, p.sh. *i parafundit*, *parafundor*, *parakapitalist*, *parashkollor*, *paraushtarak*, *i parvjen*, *parashkues*; *paraprak* (kh. mori masa *paraprake* — Q. Buxheli, Karjera, 179). Mbiemrat e formuar me këtë parashtesë tregojnë se sendet e karakterizuara prej tyre janë të vendosura në hapësirë prkt. në kohë para atyre që karakterizohen nga mbiemrat që shërbejnë si temë prodhuese për këta.

11. Parashtesa me origjinë parafjalore *për-* është pak a shumë e ku-

⁴⁴) A. Xhuvani — E. Çabej, *vep. e cit.*, 86.

fizuar në formimin e mbiemrave. Me këtë parashtesë janë formuar mbiemrat: *i përtafërt*, *i përtaundërt*, *i përtaundershëm*, *i përtaumortshëm*, *i përtauthjermë*, *i përtauthimë* e ndonjë tjetër. Kjo parashtesë besoj se ka kryesisht karakter përforcues, intensiv, por, siç vërejnë edhe A. Xhuvani — E. Çabej (vep. e cit., 90), ndonjëherë kjo tregon edhe krahasim, ngjashmëri. Disa herë mbiemri që përmban morfemën *për-* mund të jetë edhe pasojë aglutinimi e një togfjalëshi me *për* (shih formimet me paranyjëzim). Edhe në trajtimin e formimeve mbiemërore me këtë parashtesë A. Xhuvani e E. Çabej kanë përfshirë edhe raste, ku kjo është pjesë përbërëse e temës prodhuese të mbiemrave të prodhuar, kurse vetë mbiemrat janë formuar me anë të përngjitjes, paranyjëzimit e prapashtesimit e ndonjëri vetëm me paranyjëzim (kh. «*i përtaundershëm*, *i përtaundavshëm*, *i përtaundjasthëm*, *i përtaubrendshëm*, *i përtauditshëm*, *i përtaushtatshëm*, *i përtausosur* — Vep. e cit., 89).

Shënim: Në gjuhën e shkrimit janë krijuar edhe një varg parashtesash, prodhueshmëria e të cilave mund të thuhet se është e vogël; disa kanë bërë një farë rruge e të tjerat sapo kanë nisur të përdoren në disa formime të reja. Këtu mund të përmendim parashtesat: *porsa-*, *prej-* e *sapo-*, p.sh. *i porsalindur*, *i porsambirë*, *i prejardhur*, *prejfoljor*, *i sapoçliruar*, *i sapombirë*.

Ndonjëherë fjalë të tilla ende nuk ndjehen si të ngjizura dhe pjesët e tyre përbërëse shkruhen gabimisht të veçuara, p.sh. ishte në pixhama dhe *porsa i rruar* (M. Kallamata, I fundit, 29); u nda nga djali i tij *i porsa lindur* (F. Gjata, Përmbysja, 221).

12. Veçanërisht në stilin publicistik haset mjaft dendur parashtesa me origjinë latine *pro-*, e cila ka kuptim pajtues, aprovues, p.sh. *proamerikan*, *prorevizionist*, *proimperialist*, *prokapitalist* etj. (p.sh. aktivitetin e tij *proitalian* — Q. Buxheli, Karjera, 200; veprimtarisë së tij *profashiste* — po aty, 201).

13. Parashtesa me origjinë latine *stër-*, sipas A. Xhuvanit dhe E. Çabejt «u ngjitet emravet dhe foljevet, me funksione të ndryshme, ose pa ndonjë funksion të caktuar» (vep. e cit., 95). Por ajo u ngjitet edhe mbiemrave të ndryshëm, duke u dhënë kuptim superlativ, p.sh. *stërbujar*, *i stërgjatë*, *i stërllashtë*, *i stërmadh*, *i stërhollë*, *i stërkuq*, *i stërzi* etj. Kjo parashtesë është prodhimtare.

Shënim: Te M. Kuteli hasim edhe një formë *shtër-* të kësaj parashtese, p.sh. uturimë e *shtërmadhe* (M. Kuteli: Tregime 69). Këtë formë e shënojnë edhe A. Xhuvani — E. Çabej te fjalët *i shtërbardhë*, *i shtërkuq*.

14. Parashtesa me origjinë parafjalore *tej-*, siç vërejnë edhe A. Xhuvani — E. Çabej në shqipen letrare «është bërë prodhimtare në pak fjalë, (përkthime nga gjuhët e tjera)»⁴⁵. Mbiemrat e formuar me këtë parashtesë janë të paktë, p.sh. *i tejdukshëm*, *i tejpushëm*, *tejavajtës* etj.

Nga gjithë shqyrtimi i mësipërm del se ky tip fjalëformimi është relativisht prodhimtar në gjuhën shqipe. Prodhimtaria e parashtesave të lartpërmendura është e ndryshme; parashtesa më prodhimtare në lëmin e formimit të mbiemrave është parashtesa *pa-*. Si tema prodhuese këtu marrin pjesë kryesisht temat mbiemërore dhe në disa raste të veçanta temat emërore.

45) Vep. e cit., 99.

2.2. Mbiemra të prejardhur me anë të prapashtesimit.

Kjo mënyrë fjalëformimi është mënyra më prodhimtare në formimin e mbiemrave nga pjesë të ndryshme të ligjëratës. Gjithë mbiemrat e formuar me prapashtesa janë të panyjshëm. Në këtë mes një rëndësi themelore ka dallimi i mbiemrave vërtet prapashtesorë, nga ata mbiemra që mbarojnë me të njëjtat prapashtesa me të parët, por që janë formuar me një rrugë tjetër, me anë të konversionit nga emrat përgjegjës dhe sot ekzistojnë si fjalë homonime, paralelisht me njëra-tjetrën, emri dhe mbiemri i prejardhur prej tij.

Një meritë të padiskutueshme në tërheqjen e vëmendjes për këtë dukuri gjuhësore ka A. Desnickaja⁴⁶. Një dallim i tillë nuk është bërë më parë nga gramatikanët tanë. Në të vërtetë dallimi i kufirit midis këtyre dy tipeve të fjalëformimit është shumë i vështirë të bëhet pa një gjurmim të përqendruar e sistematik të çdo prapashtese veçan, gjë që do t'i kapërcente caqet e këtij punimi përmbledhës, megjithatë këtu do të bëhen përpjekjet e para në këtë drejtim; por kjo me siguri do të kërkojë studime të mëtejshme plotësuese e saktësuese, sepse orientimi vetëm me njohuritë e përgjithshme që kemi për formimet e ndryshme, është krejt i pamjaftueshëm.

Trajtimi i formimit të mbiemrave me anë të prapashtesave nis që në shkronjëtoreshën e Samiut e deri në «Prapashtesat e gjuhës shqipe» nga A. Xhuvani — E. Çabej, që është studimi më i hollësishëm e më i plotë i këtij problemi, prandaj edhe për çdo rast që do të trajtohet këtu, le të mbahet parasysh edhe ky studim.

Ndryshe nga trajtimet e mëparshme, në këtë punim formimet, kur kemi të bëjmë thjesht me prapashtesim, do të trajtohen veç nga rastet, ku si element fjalëformues, veç prapashtesimit, merr pjesë edhe paranyjëzimi.

Edhe këtu do të ndiqet rendi alfabetik i prapashtesave, duke theksuar kudo edhe dendurinë e prodhimtarinë përkatëse të tyre.

1. Prapashtesa *-ac* për mendimin tim është prapashtesë, me të cilën origjinarisht janë formuar emra, emërtime personash në bazë të një vetie a tipari të tyre. Pastaj këta emra u përdorën njëherazi edhe me vlerë mbiemri dhe si përfundim me konversion kaluan edhe në mbiemra. Më në fund, për analogji me këta, u formuan me prapashtesën *-ac* drejtpërsëdrejti disa mbiemra. Por që të vendoset një kufi midis dy tipeve të formimit në gjendjen e sotme, ashtu si edhe për rastet e tjera, është punë e vështirë pa shqyrtuar një për një frekuencën e përhapjen e çdo formimi më vete. Kështu që sot fjalët *dorac*, *frikac*, *hundac*, *këmbac*, *kurrnac*, *morrac*, *mullac*, *përtac*, *pirrac*; *qullac*; *shurdhac*, *tullac*, *thumbac*, *qyrrac* etj. sipas fjalisë, në të cilën bëjnë pjesë, sipas funksionit sintaksor përkatës, mund të jenë emra ose mbiemra⁴⁷. (Kh. portreti i *tullacit* këmishëzi — Q. Buxheli, Karjera, 306; një barkmadh *tullac* —

46) A. V. Desnickaja, *Dva tipa pridlagatel'nih v sovremennom albanskom jazyke* në «Voprosy grammatiki», 1/1960, 259v. Shih për këtë edhe A. Dhrimo, *Mbi disa çështje të klasifikimit morfologjik të mbiemrave në shqipen e sotme*, në SF, 1/1969, 49v.

47) Shih për këtë edhe Prof. Dr. Aleksandër Xhuvani — Prof. Eqrem Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962, 4 (më tej: Prapashtesat).

po aty, 309; shumë kokë të mëdha *tullace* — po aty, 305; ishte një burrë gati *tullac* — M. Kallamata, I fundit, 122).

Si mbiemra vërtet prapashtesorë, të formuar me këtë prapashtesë, mund të përmendim *ngelac* e *verdhac*.

Që kjo prapashtesë origjinarisht i përket formimit të emrave, kjo mbështetet për mendimin tim, edhe nga fakti që në serbo-kroatishten, prej nga e ka marrë shqipja, me këtë prapashtesë formohen emra⁴⁸ dhe, nga ana tjetër, edhe në gjuhën shqipe në përdorimin predikativ të këtyre fjalëve haset rëndom jo shkallëzimi (pra jo kategoria mbiemërcore), por (përkundrazi) shoqërimi i tyre me mbiemër (pra kategoria emërore): Ai është *përtac* (*thumbac*, *morrac*, *frikac* etj.) *i madh* (*i keq*, *i ndyrë*). Edhe A. Xhuvani — E. Çabej nuk kanë mundur të bëjnë ndonjë dallim në shembujt e sjellë prej tyre, se cilët janë emra e cilët mbiemra⁴⁹. E kjo ka ndodhur, sepse çdo emër ka një homonim leksikogramatikor mbiemër, kemi pra dy fjalë që kumbojnë njëllë. Mendoj se në fjalor fjalë të tilla duhet të qëndrojnë veçmas, një herë si emra e një herë si mbiemra, sepse këtu nuk kemi të bëjmë me një përdorim okazional të tyre, por me një përdorim të ngulitur mirë në gjuhë.

Siç vërejnë edhe dy autorët e lartpërmendur, kjo prapashtesë formon mbiemra «më fort me kuptim pejorativ».

Sic shihet nga shembujt e mësipërm, tema prodhuese e këtyre fjalëve është ose një emër (*dorë*, *frikë*, *hundë*, *këmbë*, *morr*, *mullë*, *qull*, *tullë*, *thumb*, *qyrra*) ose një mbiemër (*i verdhë*) ose një folje (*përtoj*, *ngel*).

2. Besoj se prapashtesa *-acak* nuk ka një shtrirje aq të gjerë sa e japin A. Xhuvani — E. Çabej⁵⁰. Edhe nga shembujt e cituar prej tyre, del që atje kemi të bëjmë me fjalë të formuara me prapashtesën *-ak* nga tema prodhuese që mbarojnë në *-ac*: *burrac-ak*, *dorac-ak*, *ferrac-ak*, *frikac-ak*, *morrac-ak*, *mullac-ak*, *rrugac-ak*, *verdhac-ak*, etj. Të gjitha këto tema ekzistojnë si fjalë të mëvetësishme në gjuhën shqipe⁵¹. Një interpretim i tillë i këtyre formimeve (pra pranimi i prapashtesës *-acak* në këto raste) do të qëndronte më tepër në planin motivues. sesa në atë fjalëformues. Nga ana tjetër, duhet pranuar me A. Xhuvanin — E. Çabejn⁵² se bashkëvajtja e vazhdueshme e këtyre dy prapashtesave në fjalët e lartpërmendura ka bërë që këto të ndjehen si një prapashtesë e vetme fjalëformuese dhe të formohen fjalë të reja me të, p.sh. *ardhacak*, *eracak*, *endacak*, *lipacak*, *ndyracak*, *rjepacak*, *shtiracak* etj. Pra këtu ka ndodhur metanaliza ose deglutinacioni, d.m.th. zhvendosja e kufinjve të morfemave në përbërjen e fjalës dhe të togfjalëshit të zakonshëm, si pasojë e së cilës morfema që më parë ishte një e vetme mund të kthehet në një varg dy morfemash, kurse vargu i dy a më shumë morfemave mund të shkrihet, në bazë të thjeshtimit, në një morfemë, duke sjellë shpeshherë lëvizjen e kufinjve të fjalëve. Edhe kjo prapashtesë ka kuptim keqësues, përbuzës. Mendoj se në të gjitha këto raste në zanafillë kemi të bëjmë me formime emërore. Mbiemrat përgjegjës këtu janë formuar me konversion, përjashtuar këtu *eracak* (qen *eracak* = që i bie gjahut në erë, në gjurmë shpejt — Fjalori, 1954, 108).

48) Shih mendimin e N. Joklit, cituar tek «Prapashtesat», 7.

49) Po aty, 6 pika 2, 3.

50) A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat*, 7.

51) Shih FI në faqet përkafëse.

52) A. Xhuvani, E. Çabej, *Prapashtesat*, 7.

3. E njëjta vërejtje duhet bërë edhe për prapashtesat *-acuk* e *acuç*, që gjithashtu nuk ekzistojnë gjithandej, por vetëm në formime prejfoljore, prandaj mbiemrat e cituar nga A. Xhuvani — E. Çabej⁵³, për mendimin tim duhet analizuar jo *belb-auck*, *verdh-acuk*; *verdh-acuç* etj. por *belbac-uk*, *verdhac-uk*, *verdhac-uq* etj. Nga ana tjetër, edhe këtu kemi raste kontaminimi, metanalize dhe formimi të një prapashtese të tillë tek fjalët *rjep-acuk*, *rjep-acuç*. Kuptimi i kësaj prapashtese është gjithashtu përbuzës, keqësues. Edhe këto fjalë duhen parë së pari si formime emërore.

4. Një prapashtesë që është bërë prodhimtare edhe në formimin e mbiemrave është prapashtesa *-ak*. Me këtë prapashtesë formohen mbiemra prej temash foljore p.sh. *lozak*, *shtinjak*, *zverdhak* etj.; prej temash emërore, p.sh. *baltak*, *bashkiak*, *burrak*, *cubak*, *cullak*; *dimërak*; *eshtak*, *fillak*, *gushtak*; *gjysmak*; *motak*; *mujak*, *rrufak*, *smirak*, *shpuzak*, *thinjak*, *vezak*, *vetiak*; *vjeshtak* etj.; prej temash ndajfoljore: *rrotullak*, *rrumbullak*; dhe prej temash mbiemërore, p.sh. *hollak*, *verdhak*, *voglak*, *zbetak* etj. (P.sh. tri zana *hidhërake* — M. Kuteli, *Tregime*, 68; plaku *hidhërak*, po aty 104 — këtu *u*-ja e temës prodhuese, *hidhur*, është reduktuar në *ë* për shkak të theksit të fjalës; atij plakut *thinjak* — po aty, 67; plakut *thinjak* e *zemërak* — po aty, 104; ca lule të vonuara *vjeshtake* — F. Gjata, *Këneta*, 411; datë e numër *rrumbullak* — Q. Buxheli, *Karjera*, 241). Kjo prapashtesë është shtrirë në formimin e mbiemrave për analogji me ato raste, kur emrat e formuar prej saj kanë kaluar në mbiemra me anë të konversionit. Ndërkaq mbiemrat *topolak* e *torollak* do të merret si fjalë e parme, sado që tek i pari është e qartë rrënja *top-i* (Kh. Dalip Qosja, farmacisti, një burrë i shkurtër, *topolak* — M. Kallamata, *I fundit*, 70; Ky kapiteni qenka *torollak* — Q. Buxheli, *Karjera*, 60).

Shënim: Te mbiemri *dhëparak* ë-ja e temës (*dhëpër*) është asimiluar nga *a*-ja e prapashtesës.

Edhe kuptimi i fjalëve të formuara me këtë prapashtesë, siç vërejnë A. Xhuvani — E. Çabej, mund të jetë pejorativ ose jo⁵⁴. Në mbiemrat që nuk kanë kuptim pejorativ por përkatësor a cilësor të drejtpërdrejtë hyjnë: *dimërak*, *eshtak*, *gushtak*, *motak*, *vezak*, *vjeshtak*, *vetiak*, *rrotullak* e *rrumbullak* (pra mund të tregojnë edhe ngjasim, formë e përkatësi).

5. Prapashtesa *-al* nuk është aspak prodhimtare në gjuhën shqipe. Ajo nuk haset fare në bashkëvajtje me tema prodhuese shqipe. Te fjala *kuqal* kemi të bëjmë me një formim emëror. Por, siç vërejnë A. Xhuvani — E. Çabej, kur kjo prapashtesë përmes metanalizës kontaminohet me prapashtesa të tjera *-ac*, *-ak*, *-ar*, *-aq*, *-ec*, *-ikë*, *-oz*, *-osh*; *-uk*, *-uq*) bëhet prodhimtare (*pikalac*, *dredhalak*, *pikalar*, *shkurtalaq*, *kuqalash*, *barkalec*, *barkaliq*, *pikaloz*, *kuqalosh* (*kuqëlosh*), *trashaluk*, *trashaluq*)⁵⁵. Këto formime janë të gjitha të gjuhës popullore. Edhe këtu një pjesë e fjalëve janë sëpari emra.

Nga gjuhët moderne ka hyrë në gjuhën shqipe një numër shumë i madh mbiemrash që mbarojnë në *-al* e *ial*. Këtu mund të dallojmë dy

53) Po aty, 8.

54) A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat*, 11.

55) Shih hollësisht, A. Xhuvani — E. Çabej, *vep. e cit.*, 12-13.

grupe: a) grupin e parë, i cili për ne është i paanalizueshëm në temë e në prapashtesë, pra këta mbiemra do të trajtohen si fjalë të parme, p.sh. *arificial, brutal, fatal, legal, moral, lokal, real, special, social* etj. dhe b) grupin e dytë, i cili vërtet është marrë i gatshëm nga gjuhë të huaja, por në gjuhën shqipe ekzistojnë edhe temat prodhuese që kanë hyrë gjithashtu nga gjuhët e huaja, p.sh. *eksperimental, ekuatorial, fiskultural, formal, frontal, global, gjenial; klerikal, koral, personal, sentimental, tropikal; diktatorial; kolonial, noterial, proverbial, territorial* etj. Përbrenda shqipes me këtë prapashtesë të huaj kemi hasur një formim të vetëm: *blegtoral* (<*blektori*); p.sh. skemave *tradicional* (Q. Buxheli, Karjera, 105); *zbulim sensacional* (po aty, 187); do të qe *ideale* (po aty, 47); mënyrë *orientale* (po aty, 9); prodhimeve bujqësore e *blegtorale* (po aty, 5). Ndërkaq mbiemri *patriarkal* do të merret si fjalë e parme, p.sh. moralit *patriarkal* (M. Kuteli, Tregime, 45). Të gjithë këta mbiemra kanë kuptim përkatësor.

6. Prapashtesa *-an* është pak prodhimtare në formimin e mbiemrave. Me këtë prapashtesë janë formuar disa mbiemra cilësorë kryesisht me kuptim pejorativ nga tema emërore (*bishtan, çudan, vetullan, zhelan*) dhe nga tema mbiemërore (*keqan, kuqan, kaleshan*). (Kh. Balozhi i zi është *keqan* — M. Kuteli, Tregime, 135). Përdorimi i këtyre mbiemrave në gjuhën letrare është shumë i kufizuar.

Në disa raste fjalëve të formuara me këtë prapashtesë u ngjiten prapashtesa të tjera, në të vërtetë parazitë, p.sh. *meksikan-as, kuban-ez*, dukuri që duhet mënjanuar nga gjuha letrare.

Shënim: Mbiemrat që mbarojnë në *-ant* kanë hyrë drejtpërsëdrejti nga gjuhët e huaja, p.sh. *alarmant, tolerant, vakant* etj. (Kh. Gjendja nuk është aq *alarmante* — Q. Buxheli, Karjera, 126; Do të ishte shumë *interesante* — M. Kallamata, I fundit, 75). Edhe për disa nga këta mbiemra në gjuhën shqipe ekzistojnë edhe temat e tyre prodhuese që kanë hyrë gjithashtu nga gjuhët e huaja.

7. Nga emra të përveçëm (personash), duke rrokur e abstraguar vetinë (tiparin) themelorë të tyre, janë formuar sipas modelesh të huaja mbiemra me prapashtesën gjithashtu të huaj *-ian*, p.sh. *epikurian, hitlerian, hrushovian, napolonian, shekspirian, drakonian* etj. Këta mbiemra kanë kuptim përkatësor dhe tipizojnë jo vetëm veprime a sende të ndryshme që lidhen me personat, emri i të cilëve shërben si temë prodhuese, por edhe ato që lidhen me ithtarët e atyre personave (Kh. arti *shekspirian, stili deradian, ligjet drakoniane, masakrat hitleriane, revizionistët hrushovianë, trojka hrushoviane* etj.).

8. Prapashtesa me burim sllav *-anik*, e cila është prodhimtare në formimin e emrave të gjuhës shqipe, ka dhënë një mbiemër të formuar nga një temë mbiemërore *trashanik* (<*i trashë*) dhe një mbiemër nga një temë emërore *faranik* (<*farë*). I pari ka kuptim pejorativ dhe pothuajse përdoret vetëm për të karakterizuar emra abstraktë (gabim *trashanik, qëndrim trashanik* etj.).

9. Një prapashtesë jashtëzakonisht prodhimtare, qoftë për formimin e emrave që për konversion kanë kaluar në mbiemra⁵⁶, qoftë për for-

56) Kh. edhe G. Weigand, *Albanische Grammatik*, Leipzig, 1913, 44.

mimin e mbiembrave vërtet prapashtesorë, analogjikë me emrat e mësipërm, është prapashtesa *-ar*.

Në grupin e dytë hyjnë mbiemrat *arbitrar, bankar, djaloshtar, elementar, krenar, legjendar, letrar, mesjetar, monetar, planetar, polar, posttar, vjeshtar* etj. Ndërsa emrat mund të formohen prej pjesësh të ndryshme të ligjëratës, mbiemrat e formuar për analogji me ta formohen vetëm nga tema emërore. Të gjithë këta mbiemra kanë kuptim përkatësor. Siç shihet, një pjesë e këtyre formimeve janë të gurrës popullore e disa të tjera janë formime të gjuhës letrare, më fort sipas modeleve të huaja (kryesisht sipas italishtes e frëngjishtes: *barkar, polar, posttar* etj.). Ka edhe raste gërshetimi midis dy modeleve.

Shënim: Kjo prapashtesë, siç e kanë vënë në dukje edhe A. Xhuvani — E. Çabej⁵⁷, mund të bashkohet edhe me prapashtesa të tjera (*-aran, -arash, -arësh, -arës, -arinë, -ariqe, -arak, -araq, -aruq, -arush, -arkë, -armë*), por duhet theksuar se fjalët e formuara nga ky aglutinim kryesisht nuk janë mbiemërore dhe, nga ana tjetër, nuk kanë gjetur përdorim në gjuhën e sotme letrare.

10. Nga bashkimi i prapashtesës *-ar* me prapashtesën *-ak* ka dalë prapashtesa *-arak* që është prodhimtare sa tek emrat edhe tek embiemrat. Ky bashkim ka ndodhur përmes metanalizës për analogji me ato raste, ku si temë prodhuese e formimeve me prapashtesën *-ak*, ishte një temë në *-ar* (Kh. *fshatar-ak*). Mbiemrat e formuar me këtë prapashtesë kanë disa herë edhe kuptim pejorativ, por jo gjithmonë (Kh. *luftarak, vjeshtarak, vezarak* — që kanë më fort kuptim përkatësor) dhe formohen a) prej temash emërore, p.sh. *foshnjarak, luftarak, shtazarak, vezarak, vjeshtarak* etj. e b) prej temash foljore *aesharak* (Kh. Më *qesharakja* nga të gjitha doli pasqyra — Q. Buxheli, *Karjera*, 24; shpirti *shtazarak* — M. Myftiu, *Leka*, 128; era *vjeshtarake* — D. Shaplo, *Përtëritje*, 95).

Shënim: Një formim të vetëm kemi hasur me prapashtesën *-ashuk*: *farashuk* (pjepër *farashuk* — FI, 114).

Shënim: Mbiemrat e formuar me prapashtesën *-atak*: *brinatak, leshatak, mishatak; pushatak* nuk kanë gjetur ndonjë përdorim të gjerë në gjuhën e sotme letrare (Kh. Në gjirin *leshatak* të malësorit — Jeta e re, 12.VIII.67, 3; Qeni *leshatak* ishte veshë si veshen karroctarët — Cuk Simoni, *Pinoku*, 75). Këta mbiemra mund të zërthehen përafërsisht në togfjalëshin *plotë gjithë + emrin që përbën temën e tyre prodhuese* (*leshatak = plot lesh*).

11. Pak prodhimtare ka mbetur në formimin e mbiembrave edhe prapashtesa *-atar*, e cila, siç shënojnë dhe A. Xhuvani — E. Çabej, «nuk është veçse një variacion i *-tar-it*, i njëjtë me këtë edhe në funksionet që ka»⁵⁸. Me këtë prapashtesë janë formuar mbiemrat *gjakatar* e *mesatar* nga temat emërore *gjak* e *mes*.

Shënim 1: Përsa i përket prapashtesës *-e* si formuese mbiembrash, unë mendoj se kjo prapashtesë nuk ekziston. Ajo është e tillë vetëm në formimin e emrave të mocionit; pra në formimin e një emri të gjinisë femërore nga përgjegjësi i tij mashkullor (Kh. *derr-e, milor-e, gjysh-e, trim-e, dinak-e, fshatar-e, komunist-e, punëtor-e, qytetar-e* etj.), kurse te mbiemrat përgjegjës të gjinisë femërore, sido që të jetë puna, nuk kemi të bëjmë me fjalëformim, e si rrjedhim nuk kemi të bëjmë me pra-

57) A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat*, 19.

58) A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat*, 24.

pashtesë, siç mendojnë A. Xhuvani — E. Çabej⁵⁹. Për shpjegimin e rasteve të tipit: vajzë *dinake*, grua *trime*, klasë *punëtore* etj., ka dy mundësi: a) përderisa ekzistojnë emrat e gjinisë femërore plotësisht të njëjta me këta, atëherë këta emra, si edhe mjaft të tjerë që kemi përmendur, kanë kaluar me konversion edhe në mbiemra; pra, tek mbiemrat *fshatëtare*, *dinake*, *punëtore* etj. do të kishim të bënim me fjalëformim për konversion nga emrat *fshatëtare*, *dinake*, *punëtore* etj.; b) mundësia e dytë, që ka një bazë më të përgjithshme — mbarë sistemin mbiemëror -, është kjo: në fillim ka ndodhur kalimi i emrave *fshatar*, *dinak* etj. me konversion në mbiemra. Pra, këtu ka ndodhur fjalëformimi me konversion, ndërsa tek *dinake*, *fshatëtare*, etj. nuk kemi të bëjmë as me konversion nga emrat e gjinisë femërore, as me prapashtesën *-e*, por vetëm me mbaresën femërorizuese *-e*, si tek gjithë mbiemrat e tjerë.

Unë anoj më tepër nga mundësia e dytë, që është më e përgjithshme.

Shënim 2: Në gjuhën letrare, sidomos në publicistikë, kanë hyrë nga gjuhët e huaja moderne një numër mbiemrash në *-ent*. Këta kanë hyrë në gjuhën shqipe drejtpërsëdrejti nga gjuhët e huaja dhe janë të paanalizueshëm, p.sh. *dekadent*, *elokuent*, *imanent*, *indiferent*, *inteligjent*, *intrasigjent*, *koherent*, *kompetent*, *latent*, *permanent*, *transparent*, *urgjent*, *vigjilent* etj.

Shënim 3: Një prapashtesë e gurrës së huaj, me të cilën formohen disa mbiemra me kuptim përkatësor e herë-herë keqësues nga tema emërore, është prapashtesa *-esk*. Kjo prapashtesë është pak prodhimtare, haset më shpesh në prozën shkencore e publicistike por ndonjëherë edhe në letërsinë artistike. Me këtë prapashtesë janë formuar mbiemrat: *aventuresk*, *donkishotesk*, *libresk*, *studentesk*, *shkollaresk*, *shkrimtaresk* etj.

12. Një prapashtesë e krijuar gjithashtu nëpërmjet metanalizës është edhe prapashtesa *-ëror*. Kjo prapashtesë është krijuar nëpërmjet metanalizës së mbiemrave të krijuar me anë të prapashtesës *-or* nga tema emërore që mbarojnë në *-ër* (*arbër-or*, *dimër-or*, *emër-or*, *femër-or*, *virgjëror* e më fort *burrëri-or*, *mbretëri-or*, *shoqëri-or*, *vajzëri-or*, ku si temë prodhuese ka shërbyer një emër abstrakt. Siç shihet, *i-ja* e temës prodhuese para prapashtesës ka rënë). Me anë të kësaj prapashtese janë krijuar mbiemrat: *atëror*, *botëror* e *shtetëror*.

13. Një prapashtesë jashtëzakonisht prodhimtare për formimin e mbiemrave në gjuhën shqipe, sidomos në atë letrare, është prapashtesa *-(ë)s*. Me këtë prapashtesë formohen mbiemra që tregojnë marrëdhënien e sendit të karakterizuar ndaj një veprimi të shprehur nga tema prodhuese. Këta mbiemra kanë kuptim vepror (aktiv), tregojnë tiparin e vepruesit, të atij që kryen veprimin e emërtuar nga tema prodhuese, por megjithatë nuk mungojnë rastet, kur këta mbiemra kanë më se një kuptim (Kh. spec *djegës* «që djeg» — lëndë *djegëse* «që digjet, e djegshme»). Si tema prodhuese për këtë nëntip fjalëformimi shërbejnë: a) tema e shkurtuar e pjesores (pa *-ur* ose *-r*) së foljeve. Kjo shërben si temë prodhuese për mbiemrat e prejardhur nga pjesoret e foljeve me temë në bashkëtingëllore, në *-e* ose *-ye*, p.sh. *grindës*, *hedhës*, *mbytës*, *ngjitës*, *përmbledhës*, *përsëritës*, *shkrepës*, *zhuritës*, *kërcyes*, *shpërblyes*, *ushqyes*,

59) Po aty, 31 (*bujare*, *dinake*, e *dëshirueshme*, e *pëlqyeshme*). Për rastet e *dëshirueshme*, e *ndershme*, e *pëlqyeshme* që jepen aty, as që mund të shtohet fare problemi i një prapashtese mbiemërformuese *-e*; atje është e qartë që kemi të bëjmë me mbaresë femërorizuese.

thyes etj. b) tema e plotë e pjesores. Kjo shërben si temë prodhuese në ato raste, kur pjesorja e foljes mbaron në -ë, p.sh. *ngrënës, dhënës, marrës, mbjellës, shirës, pirës, prerës* etj. c) tema e foljeve në -o. Përsa u përket këtyre formimeve, këtu dalin një varg çështjesh. Në këto raste në të dyja dialektet kemi rrugë të ndryshme për formimin e mbiemrave përkatës. Në gjuhën letrare po merr një shtrirje gjithmonë e më të gjerë, është shndërruar në normë ajo mënyrë formimi që është karakteristike për gegërishten, nga pjesorja gege dhe prapashtesa -s (*tregue+s, shkar-kue-s, drejtue-s, qërtue-s* etj.). Ndërkaq ky nëntip fjalëformimi, duke u përdorur kaq gjerë në gjuhën letrare shqipe, po shtrihet analogjikisht edhe në raste, të cilat gegërishtja nuk i ka. Nga ana tjetër, sot folësit e gjuhës së përbashkët letrare kombëtare, kur përdorin një mbiemër të tillë në -s, nuk kanë më aspak parasysh pjesoren gege, por thjeshtë temën e foljes. Atëhere për shpjegimin e këtyre formimeve në planin e gjuhës së sotme të përbashkët letrare kombëtare ka dy rrugë: 1) Të pranohet që në këtë nëntip fjalëformimi merr pjesë tema e foljeve dhe një prapashtesë -ues: ⁶⁰ *qërto+ues > qërtues* (o-ja e temës bie, si te *puno+im > punim*), *shkarko+ues > shkarkues*, *arësyeto+ues > arësytues* ose 2) të pranohet që në këtë nëntip fjalëformimi merr pjesë tema e foljeve dhe prapashtesa -s, veçse o-ja e temës së foljes këtu zërthehet në -ue (ashtu si zërthehet në -ua te pjesorja): *ofendo+s > ofendue*, *mbizotëro+s > mbizotërues*. Për foljet me temë në -ua në këto raste duhet pranuar alternimi i grupit zanor -ua në -ue, p.sh. *kruaj-krues, bluaj-blues* etj. Unë anoj nga interpretimi i dytë që e pranon zërthimin e o-së në -ue dhe alternimin e -ua në -ue si fakt të gjuhës së sotme letrare, barabar si pranon zërthimin e saj në -ua: o-ua-ue.

14. Një prapashtesë e re dhe jo shumë prodhimtare për formimin e mbiemrave është prapashtesa -ësor. Kjo prapashtesë ka lindur nëpërmjet metanalizës së fjalëve të formuara me anë të prapashtesës -or nga tema që mbarojnë në -ësi (*miqësi+or*, shih pikën 18b). Me këtë prapashtesë janë formuar nga tema emërore mbiemrat përkatësorë *gjqësor, jetësor, nëntokësor, paqësor, rrënjësor, tokësor*. Edhe mbiemri *anësor*, megjithëse ekziston emri abstrakt *anësi-a*, është formuar nga tema *anë* dhe prapashtesa -ësor, sepse tregon se sendi i dhënë ndodhet në *anë* e jo që ka të bëjë me *anësinë*. E parë më fort në planin motivues, këtu do të hynte edhe fjala *gjakësor*, e cila në planin fjalëformues do shpjeguar nga *gjakës*.

15. Një prapashtesë, e cila në shqipen letrare mund të themi se nuk është aspak prodhimtare, është prapashtesa -ik, me të cilën është formuar ndonjë mbiemër nga tema emërore ⁶¹. I vetmi mbiemër që haset edhe në gjuhën letrare është *jetik*. Por me këtë prapashtesë kanë hyrë në shqipen letrare një numër jashtëzakonisht i madh mbiemrash me kuptim përkatësor drejtpërsëdrejti prej gjuhësh të huaja, p.sh. *agronomik, akademik, alfabetik, anatomik, aristokratik, automobilistik, biografik, demografik, diplomatik; enigmatik, etik, erotik, filantropik, komik, magjik, nordik, profetik* etj.

60) Një prapashtesë të tillë e pranojmë. A. Xhuvani — E. Çabej, *vep. e cit.*, 98. Megjithatë varianti -uas i kësaj prapashtese që jepet nga autorët, mendoj se nuk përlligjet. Në formimet e tipit *liruas* kemi të bëjmë me formime nga tema e shkurtuar e pjesores (pa -r) dhe prapashtesa -s (*lirua/r/+s*).

61) Shih edhe A. Xhuvani — E. Çabej, *po aty*, 50.

Është për t'u theksuar se në mjaft raste në gjuhën shqipe janë huazuar edhe temat prodhuese të këtyre mbiemrave. — Këto janë emra abstraktë që mbarojnë në *i-* të theksuar ose në *ikë* (Kh. *daktilografi*, *simetri*, *akustikë*, *lirikë* etj.), por në ndonjë rast edhe pa ndonjë mbaresë dalluese *alfabetik* (*alfabet*), *algjebrik* (*algjebër*), *enigmatik* (*enigmë*) etj.

Disa mbiemra që kanë si temë prodhuese një emër në *-ikë*, nuk i gjejmë të formuar me prapashtesën e huaj *-ik*, por me prapashtesën vendase *-or* (Kh. *gjimnastikë-gjimnastikor*, *gramatikë-gramatikor*, *muzikë-muzikor*, e ndonjë tjetër).

Shënim 1: Nga gjuhët e huaja kanë hyrë në gjuhën shqipe edhe pak mbiemra përkatësorë me prapashtesën *-in*, p.sh. *alpin*, *dalmatin*, *kristalin*.

Shënim 2: Nga gjuhët e huaja kanë hyrë drejtpërsëdrejti në gjuhën shqipe një numër i madh mbiemrash në *-iv*. Këta mbiemra janë përkatësorë dhe të formuar nga tema emërore. Në mjaft raste në gjuhën shqipe është huazuar edhe tema prodhuese e atëhere — sadoqë mbiemri është i huaj — është plotësisht e mundshme analiza e tij në elementët përbërës, p.sh. *administrativ*, *edukativ*, *efektiv*, *federativ*, *informativ*, *intuitiv*, *kursiv*, *objektiv*, *produktiv*, *sportiv* etj.

Siç është vënë në dukje në § 1, ka edhe mjaft të tillë, tema prodhuese e të cilëve nuk ekziston e mëvetëshme në gjuhën shqipe, e që për këtë arsye do të trajtohen si fjalë të parme, p.sh. *alternativ*, *aproksimativ*, *eksploziv*, *intensiv*, *naiv*, *pozitiv* etj.

Shënim 3: Drejtpërsëdrejti nga gjuhët moderne kanë hyrë në gjuhën letrare shqipe edhe disa mbiemra që mbarojnë në *-ist*, të cilëve herë mund t'u hetohet tema prodhuese *ekspansionist* (*ekspansion*), *simbolist* (*simbol*) e herë nuk mund të hetohet dhe do të merren gjithashtu si fjalë të parme, p.sh. *altruist*, *optimist* etj.

16. Megjithëse nuk përbën më normë në gjuhën letrare shqipe, prapëseprapë ende mjaft i rëndomtë është këtu formimi i mbiemrave me anë të prapashtesës *-njës*. Në të vërtetë në krye të herës në formimet e këtij tipi kemi pasur të bëjmë me prapashtesën *-(ë)s*, e cila ishte jashtëzakonisht prodhimtare dhe me denduri të madhe në toskërishten për formimin e mbiemrave veprorë nga temat foljore. Për foljet me temë në *-o* si temë prodhuese për mbiemrat veprorë këtu shërbente forma e vetës së parë njëjës e këtyre foljeve, në mënyrën dëftore në kohën e tashme, formë që sot edhe në toskërishten e folur po del nga përdorimi: *tregonj+ës* > *tregonjës*, *qërtonj-ës* > *qërtonjës* etj. Përderisa kjo formë e foljes sot nuk ekziston më sidomos në gjuhën letrare, atëhere sot këta mbiemra formohen nga tema e foljeve përkatëse, ndërsa elementi *-nj* — është bërë pjesë përbërëse e prapashtesës: *dërmo-njës*, *lehtëso-njës*, *prodho-njës*, *rëndo-njës*, *sundo-njës* etj. Kështu, për mendimin tim, në përcaktimin e kësaj prapashtese ka të drejtë O. Myderrizi që pranon një prapashtesë *-njës*. dhe jo A. Xhuvani — E. Çabej⁶² që pranojnë një prapashtesë *-onjës*. Po e shikuar këtë dukuri gjuhësore në plan historik, kemi të bëjmë me prapashtesën *-(ë)s*; po e vështruar në plan sinkronik, kemi të bëjmë vetëm me *-njës*, *o-ja* i përket temës prodhuese.

60) O. Myderrizi, *vep. e cit.*, 79; A. Xhuvani — E. Çabej, *vep. e cit.*, 76 (i vetmi rast, ku mund të pranohej një prapashtesë *-onjës* do të ishte fjala *shkronjës*, por, siç thonë me të drejtë edhe dy autorët, kjo fjalë do të ketë dalë nga emri *shkronjë-a* me prapashtesën *-s*, pra jo nga tema e foljes).

17. Joprodhimtare ka mbetur edhe prapashtesa *-oç*, me të cilën janë formuar shumë pak mbiemra nga tema emërore, p.sh. *brinoç*, *faroç* e ndonjë tjetër.

18. Prapashtesë shumë prodhimtare e shqipes së sotme letrare, për sa i përket formimit të mbiemrave, është edhe prapashtesa *-or*. Edhe kjo në zanafillë i përket gjithashtu sistemit emëror⁶³, por në analogji me emrat që me anë të konversionit kanë kaluar në mbiemra, u shtri edhe në formimin e mbiemrave prapashtesorë. Mbiemrat e formuar me anë të kësaj prapashtese kanë kryesisht kuptim përkatësor, megjithatë ideja e përkatësisë nuk shprehet barabar te të gjithë këta mbiemra. Një pjesë e tyre (*armiqësor*, *djallëzor*, *hyjnor*, *miqësor*, *shembullor* etj.), duke pasur edhe si temë prodhuese një emër abstrakt, kanë shkuar më tepër drejt shprehjes së cilësisë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Mbiemrat e formuar me anë të prapashtesës *-or* kanë si temë prodhuese: 1) një temë emërore, p.sh. a) *ajëror*, *arësimor*, *barishtor*, *diellor*, *foshnjor* (që është pjesërisht i afërt me *foshnjarak*, por ndryshon prej tij, sepse ndërsa *foshnjarak* ka gjithmonë kuptim pejorativ, *foshnjor* mund të ketë ndonjëherë kuptim pejorativ, kurse zakonisht përdoret si neutral me kuptim thjesht përkatësor), *kurrizor*, *popullor*, *qendror*, *shembullor*, *verior*, *veror*; *armiqësor*, *bujqësor*, *cilësor*, *gjuhësor*, *miqësor*, *lëhtësor*, *djallëzor*, *hyjnor*, *fisnor* etj. 2) një temë foljore. Këtu hyjnë disa formime të vona, më tepër të gjuhëtarëve tanë, p.sh. *dëshirore*, *pësor*, *dëftor*, *lindor*, *fillor*, *kallëzor*, *pohor*, *krahasor*, (ndoshta, edhe) *vepror* etj. 3) një temë mbiemërore: *gjatore* (kumbull *gjatore*).

Mbiemrat *armiqësor* e *miqësor* janë formuar prej emrave abstraktë që mbarojnë në *-ësi* (*armiqësi* *miqësi*), dhe prapashtesa *-or*. A. Xhuvani dhe E. Çabej nuk kanë mbajtur një qëndrim fort të qartë lidhur me këta dy mbiemra. Ata i japin së pari te prapashtesa *-(ë)sor*, duke i quajtur neologjizma. Pastaj, kur shpjegojnë formimin e prapashtesës *-(ë)sor* «nga emrat femërorë në *-(ë)si*, duke zëvendësuar *-i*-në e këtyre me *-or* *-uer*», vazhdojnë: «Prej këtyre emrave e mbiemrave përkatës si *armiqësor* ajo u përhap edhe në të tjera fjalë, si *tokësor*⁶⁴.» Ndërkaq te formimet me prapashtesën *-or* këta dy mbiemra nuk përmenden më. Pra, ku hyn *armiqësor*, te formimet me *-ësor* apo te ato me *-or*, nuk del e qartë.

Shënim: Tek mjaft mbiemra që formohen me këtë prapashtesë, zanorja fundore e temës prodhuese para kësaj bie: *barisht/elor*, *folj/elor*, *cilësi/-or*, *djallëz/i/-or* etj. Mbiemri *fisnor* nuk motivohet aq lehtë në shqipen e sotme letrare, sepse ka hyrë si leksemë e gatshme nga dialekti verior.

Kjo prapashtesë veçdase ka prirje të shtohet si parazitë edhe në rdonjë rast, ku tashmë është formuar mbiemri me anë të një prapashtese tjetër, p.sh. *statistik-or*, *stilistik-or*, *pyetës-or*. Për prodhimtarinë shumë të madhe të kësaj prapashtese në vitet e fundit, siedhe për disa formime jo fort të goditura me këtë prapashtesë, shih A. Dhrimo: *Mbi disa çështje të klasifikimit*... SF, 1/1969, 56 shën. 25.

19. Jo fort prodhimtare në formimin e mbiemrave është edhe prapashtesa *-osh*, me të cilën janë formuar mbiemra cilësorë kryesisht me kuptim përkëdhelie e disa herë keqësues (pejorativ) nga tema mbiemërore

63) Shih hollësisht për këtë edhe A. Desnickaja, vep. e cit. 300.

64) A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat*, 45.

(*bardhosh, blerosh, kuqosh, gjerosh, gjatosh, kaltërosh, thartosh, verdhosh, ziosh* etj.); por edhe nga disa tema emërore (*dimërosh, majosh, gushosh* etj.), p.sh. drejt detit *kaltërosh* — Adriatiku, 31.VII.67, 4.

Shënim. Prapashtesa me origjinë shqipe -os, oz⁶⁵ nuk është bërë aspak prodhimtare në shqipen e sotme letrare. Përkundrazi nga gjuhët moderne kanë hyrë në gjuhën letrare shqipe një numër i madh mbiemrash që mbarojnë me këtë prapashtesë, p.sh. *ambicioz, kurioz, luksoz, nervoz, poroz, rigoroz, studioz, supersticioz, xheloz* etj. Për disa nga këta mbiemra hetohet edhe tema prodhuese, e cila është huazuar gjithashtu nga gjuhët e huaja, ndërsa të tjerët do të shikohen si fjalë të parme.

20. Një prapashtesë që është shtrirë në formimin e mbeimrave gjithashtu nën ndikimin e formimeve me anë të konversionit nga emrat përgjegjës, është prapashtesa -tar. Me këtë prapashtesë janë formuar mbiemra që tregojnë marrëdhënje përkatësose të sendit të karakterizuar ndaj një sendi tjetër, emri i të cilit përbën temën prodhuese të mbiemrit përkatës. Këta mbiemra formohen nga tema emërore p.sh. *amtar, kishëtar, kombëtar, mesdhetar, përfaqësimitar, përfundimtar, shkatërrimtar, tregimtar, vendimtar* etj. Tek mbiemri *gjitare* (meqë përdoret vetëm për gjininë femërore), mund të vështrohen edhe mbaresa femërorizuese -e si pjesë përbërëse e prapashtesës, kështu që si prapashtesë mund të pranohet -tare.

21. Joprodhimtare në formimin e mbiemrave ka mbetur edhe prapashtesa -tor, me të cilën janë formuar mbiemrat *baritor* me kuptim përkatësor dhe *leshtor* me kuptim cilësor të drejtpërdrejtë.

22. Në gjuhën popullore hasen edhe formime mbiemrash me anë të prapashtesës -uk, nga tema mbiemërore (*bardhuk, laruk, marruk, verdhuk* etj.) dhe nga tema emërore *vjeshtuk* (mollë *vjeshtuke*, duhan *vjeshtuk* — Fjalori, 1954, 614). Këta mbiemra kanë herë kuptim përkëdhelie, herë kuptim keqësues e ndonjëherë (si p.sh. *vjeshtuk*) janë paralele me formimet me prapashtesat -or e -ak).

23. Mjaft mbiemra formohen prej temash mbiemërore edhe me anë të prapashtesës -ush, e cila ka kryesisht kuptim zvogëlimi e përkëdhelie (*bardhush, bukurush, gjatush, gjerush, larush, thatush, verdhush* etj.), por ndonjëherë, më tepër nën ndikimin e temës prodhuese, mbiemri ka kuptim keqësues (*gojush*). Mbiemrat *gojush* e *sorrush* formohen me anë të kësaj prapashtese nga temat emërore *gojë* e *sorrë*.

Nga sa u vu në dukje në hyrje të formimit të mbiemrave me anë të prapashtesimit dhe nga sa doli edhe gjatë shtjellimit të dendurisë, prodhimtarisë e prejardhjes së prapashtesave të ndryshme, me të cilat formohen mbiemra, bie në sy që në mjaft raste kemi përputhje (homonimi) midis emrave dhe mbiemrave (gjë që do të shihet edhe më për së afërmi te formimi i disa mbiemrave me anë të konversionit nga emrat përgjegjës). Duhet theksuar se në këtë drejtim në gjuhën shqipe ka një prirje për të bërë një dallim të qartë në mjetet e fjalëformimit, konkretisht në prapashtesat për rastet që edhe leksikalisht edhe gramatikisht janë të ndryshëm nga njëri-tjetri: emër-mbiemër (pra përdoren prapashtesa të ndryshme e jo formimi me konversion). Në këto raste prapashtesat -ar, -tar kanë nisur të specifikohen vetëm për emrat, ndërsa prapashtesa -or, e në disa raste edhe -(ë)s, për mbiemrat, p.sh. *arësimtar-arësimor, gojëtar-*

65) Po aty, 79.

gojor, gjuetar-gjuajtës, shkencëtar-shkencor, shkaktar-shkakor, shkrimtar-shkrimor, pronar-pronor, ditar-ditor, shkollar-shkollor, vjetar-vjetor, ëndërrimtar-ëndërrues etj. Duhet thënë se në disa raste mbiemrat janë formime më të reja në krahasim me emrat; pra kanë ekzistuar emrat pa mbiemrat përgjegjës. Megjithatë ende sot e gjithë ditën nuk ka formë të prerë midis këtyre formimeve e bile edhe e njëjta fjalë mund të ndeshet me të dy përdorimet, p.sh. Ata kujtojnë se janë *ëndërrimtarë*, kurse janë vetëm gjumashë (M. Kallamata, I fundit, 256); Pamja e Blertës ishte *ëndërrimtare* (A. Abdihoxha, Tri, I, II).

2.3. Mbiemra të prejardhur me anë të paranyjzimit e prapashtesimit njëkohësisht.

Megjithëse për nga numri i prapashtesave që marrin pjesë në të, ky tip fjalëformimi nuk është aq prodhimtar (gjithsejt marrin pjesë katër prapashtesa), për nga denduria e mbiemrave të formuar me këto prapashtesa kjo mënyrë mund të thuhet se është ndër më prodhimtare. Deri tani kjo mënyrë fjalëformimi është parë së bashku me formimet thjesht prapashtesore, por mendoj se roli fjalëformues i nyjës së përparme te ky tip është i pamohueshëm e po aq i rëndësishëm sa ai i prapashtesës, prandaj këtu u nxor veçmas. Prapashtesat që marrin pjesë në këtë tip fjalëformimi janë: *-ë*, *-(ë)m(ë)*, *-(ë)t(ë)* dhe *-shëm*.

1. Formimi i mbiemrave me anë të paranyjzimit dhe prapashtesës *-ë* nuk është as i dendur e as prodhimtar në shqipen e sotme. Pavarësisht se si mund të jenë formuar historikisht, në planin motivues si mbiemra të formuar me paranyjzim dhe prapashtesën *-ë* në shqipen e sotme letrare ndjehen disa mbiemra cilësorë të drejtpërdrejtë që kanë si temë prodhuese tema ndajfoljore, p.sh. *i drejtë*, *i fortë*, *i lartë*, *i largë*, *i shpejtë*, *i thjeshtë*, *i vërtetë* e ndonjë tjetër.

2. Prapashtesa *-(ë)m(ë)* është mjaft prodhimtare. Me anë të kësaj prapashtese dhe të paranyjzimit formohen mbiemra 1) prej temash emërore, p.sh. *i fisëm*, *i mesëm*, *i sorrmë* etj.; 2) prej temash mbiemërore, p.sh. *i epërm*, *i parmë* etj. 3) prej temash ndajfoljore, p.sh. *i andejmë*, *i këtejme*, *i nesërm*, *i pasëm*, *i poshtëm*, *i sipërm*, *i sivjemë*, *i tejmë* etj. Te mbiemrat *i ndërmjemë* dhe *i sivjemë* është asimiluar *t*-ja e temës prodhuese para prapashtesës. Mbiemri *i mëtejme* është formuar nga forma e shkallës krahasore të ndajfoljes *tej* (*më tej*) me anë të përngjitjes së këtij togu dhe të paranyjzimit e prapashtesimit të tij. Në këtë mënyrë mund të formohen edhe mbiemra të tjerë nga lokucione ndajfoljore. Ndërsa mbiemrat *i fisëm*, *i sorrmë*, janë cilësorë të drejtpërdrejtë, mbiemrat e tjerë janë përkatësorë.

Shënim: Në dialektin e veriut formanti *-m-* është përdorur si formant formëformues për pjesoren. E gjejmë të rregullt te K. Kristoforidhi, C. Simoni e H. Mosi; bile te ndonjë autor tjetër verior haset edhe me *-un* të shtuar mbrapa (*bamun*, *shkruemun*). Por, duke i parë mbarë autorët gegë, del se kjo formë e pjesores erdhi duke u zhdukur dhe si rrjedhim *-m-*ja po e humbet atje karakterin formëformues për formimin e pjesores e po fiton atë fjalëformues të mbiemrave nga tema pjesore në *-ue*. (*i lëshuem*, *i mbaruem*, *i ndemë*, *i ngrimë*, *i kryem*, *i tjerrmë* etj.). Nga ana tjetër, në gjuhën e sotme letrare ky nëntip fjalëformimi (nga pjesorja e prapashtesa *-m*) nuk ka gjetur përdorim.

Shënim: Një prapashtesë që ka mbetur joprodhimtare në shqipen e sotme letrare, është prapashtesa -ër. Me këtë prapashtesë dhe me paranyjëzim janë formuar disa mbiemra nga tema ndajfoljore, emërore ose mbiemëror, p.sh. *i poshtër, i shkurtër, i vjetër, i shurdhër.*

3. Edhe formimi i mbiemrave me anë të paranyjëzimit e prapashtesës -(ë)t(ë) është shumë i rëndomtë. Kjo mënyrë ndeshet shumë dendur dhe është mjaft prodhimtare në shqipen e sotme. Prapashtesa -(ë)t(ë) përdoret kryekëput në formimin e mbiemrave.

Me paranyjëzim dhe me anë të kësaj prapashtese formohen gjithë mbiemrat lëndorë. Si tema prodhuese këtu shërbejnë tema emërore, p.sh. *i artë, i arrtë, i bredhtë, i gurtë, i kristaltë, i mermertë, i pambuktë, i qarrtë, i sadeftë, i xhamtë* etj.

Shënim: Disa mbiemra lëndorë kanë si temë prodhuese formën e shumësit të emrave përkatës, p.sh. *i drunj-të, i florinj-të, i grunj-të (i grynjtë).*

Veç mbiemrave lëndorë nga tema emërore formohen edhe një varg mbiemrash cilësorë që nuk tregojnë tipare lëndore, por tipare cilësore, p.sh. *i dyshimtë, i flaktë, i hirtë, i lugët, i ndertë, i rrafshhtë, i rregullt, i zjarrtë etj.* Nga përngjitja e togfjalëshit parafjalor, paranyjëzimi dhe prapashtesa -t formohen edhe mbiemrat *i panumërt, i pashembullt, e i përzëmërt*, p.sh. Arroganca e zotit Zyber Çaka që e *pashembullt* (Q. Buxheli, Karjera, 34); Pas bisedës së *përzëmërt* që kishte pasur në telefon (Po aty, 44); xixat e panumërta (S. Xhai: Qyteti, 150). aty, 44); xixat e *panumërta* (S. Xhai: Qyteti, 150).

Një varg mbiemrash formohen me paranyjëzim dhe me këtë prapashtesë nga tema foljore, p.sh. *i cofët, i çelët, i fishkët, i frytë, i fshehtë, i ftohtë, i hapët, i kthjellët, i mbyllët, i mekët, i mprehtë, i ndytë, i ngrohtë, i nxehtë, i pjerrët, i rreshkët, i ulët, i zbëhtë* etj. Në të vërtetë historikisht mbiemrat e këtij grupi formohen nga paranyjëzimi i pjesoreve të vjetra në -t, por në ndjenjën e sotme gjuhësore dhe në gjuhën e sotme shqipe një pjesore e tillë nuk ekziston më, e pra edhe motivimi i mbiemrave përkatës nga kjo pjesore nuk qëndron, prandaj këtu si temë prodhuese do të merret e tashmja e foljeve përkatëse.

Sa kohë që në shqipen e sotme ekzistojnë mbiemrat *i afër, i largë, i lirë* etj., nuk besoj që mbiemrat *i afërt, i largët* e *i lirët* të jenë formuar nga ndajfoljet përgjegjëse⁶⁶, por nga këta mbiemra, për më tepër kur format e dyta në -t, siç pohojnë A. Xhuvani — E. Çabej, janë relativisht të reja (vep. e cit., 91).

Një numër mbiemrash formohen me paranyjëzim e me prapashtesën -t(ë) nga tema ndajfoljore, p.sh. *i kollajtë, i kundërt, i rëndomtë, i shpesh-të* etj.

Po me paranyjëzim dhe me këtë prapashtesë formohen mbiemra nga tema numërore prej numrit *dy* e lart (*i dytë, i tretë, i katërt, i pestë* etj.). Kur tema numërore mbaron në -t(ë), atëhere mbiemri i prejardhur nuk e merr prapashtesën -t(ë), por vetëm nyjën e përparme (*i gjashtë, i shtatë, i tretë, i njëzetë* etj. — te ky i fundit merr edhe prapashtesën -ë).

Shënim: Te ndonjë mbiemër që tregon lëndë në vend të prapashtesës së plotë -të haset vetëm ë si pasojë e asimilimit: *i ergjëndë*; në disa raste të tjera kjo prapashtesë ka rënë fare, meqë tema prodhuese mbaron në -të, ashtu si numërorët e mësipërm, p.sh. *i baltë, i kreshtë.*

66) Sh. Demiraj, vep. e cit., I, 83; A. Xhuvani — E. Çabej, vep. e cit., 90.

4. Prapashtesa më prodhimtare në formimin e mbiemrave në gjuhën shqipe është prapashtesa *-shëm*. Kjo është bërë veçanërisht prodhimtare dy dhjetvjetshat e fundit. Pothuajse prej çdo foljeje mund të formohet një mbiemër me paranyjëzim dhe me këtë prapashtesë. Kjo shquan si nga numri i mbiemrave që formohen me të, ashtu edhe nga temat prodhuese që marrin pjesë në këtë nëntip fjalëformimi. Këtu marrin pjesë: a) tema emërore, b) tema ndajfoljore dhe c) tema foljore. a) Nga temat emërore mund të shërbejnë si tema prodhuese gjithfarë emrash (konkretë e abstraktë) të përgjithshëm në numurin njëjës; emrat që mbarojnë në *-ë* të pakteksuar (ndonjëherë edhe në *-e*: *i hijshëm, i ndërgegjshëm*) e bjerrin këtë zanore para prapashtesës; p.sh. *i arësyeshëm, i bujshëm, i dëmshëm, i famshëm, i fuqishëm, i ligjshëm, i logjikshëm, i ndershëm, i ngeshëm, i nevojshëm, i njerëzishëm, i rrufeshëm, i shijshëm, i stuhishëm, i ujshëm, i zakonshëm* etj.

Shënim: Te këta mbiemra ndodh shpeshherë që prapashtesa *-shëm* ndeshet me tingullin fundor *-t* të temës prodhuese dhe në gjuhën e folur popullore i gjithë kompleksi tingullor *-tshëm* shndërrohet në *-çëm*. Përdorime të tilla ndeshen edhe në gjuhën letrare, por duhen mënjanuar prej saj, p.sh. Por qe një i ftohtë i thatë dhe *i lezeçëm* (S. Xhai: Qyteti, 215).

Mbiemrat e formuar nga tema emërore tregojnë aftësi, mundësi a të qenë në gjendje dhe kanë kuptimin që sendi i karakterizuar prej tyre «e ka sendin, emri i të cilit përbën temën prodhuese të mbiemrit», pra ata mund të zërthehen në: «që ka (që ka mundësi të ketë) + emrin e temës prodhuese» ose «me+emrin e temës prodhuese» (*i arësyeshëm* = që ka arësye, mund të arësyetojë, me arësye; *i famshëm* = që ka famë, me famë; *i fuqishëm* = që ka fuqi, me fuqi etj.) Por mund të tregojë edhe «që sjell (që ka mundësi të sjellë) sendin, emri i të cilit përbën temën prodhuese të mbiemrit përkatës» (*i andshëm* = që sjell andje, *i dëmshëm* = që sjell dëm, *i dobishëm* = që sjell dobi, *i frytshëm* = që sjell fryt etj).

b) Te mbiemrat e formuar nga tema ndajfoljore si tema prodhuese mund të shërbejnë ndajfolje të thjeshta ose lokucione të ndryshme ndajfoljore, të cilat gjatë formimit të mbiemrave me paranyjëzim e prapashtesim i nënshtrohen edhe përngjitjes, p.sh. *i brendshëm, i djeshëm, i deritanishëm, i dikurshëm, i domosdoshëm, i gatshëm, i hershëm, i këtu-shëm, i mëparshëm, i mëtejshëm, i njëkohshëm, i parakohshëm, i përher-shëm, i përditshëm, i përjavshëm, i përvitshëm, i qëparshëm, i sotshëm* etj. Këta mbiemra kanë kryesisht kuptim përkatësor, ruhet lidhja me kuptimin e temës prodhuese përkatëse.

c) Për mbiemrat e formuar me këtë prapashtesë nga tema foljore si temë prodhuese mund të shërbejë:

1) tema e shkurtuar e pjesores (pa *-ur* e *-r(ë)*). Kjo shërben si temë prodhuese për mbiemrat e prejardhur nga pjesoret e foljeve me temë në bashkëtingëllore, dhe të foljeve me temë në *-e, i dhe-ye*, p.sh. *i ardhshëm, i bëshëm, i çuditshëm, i djegshëm, i dhimshëm, i falshëm, i kapshëm, i kapërcyeshëm, i lodhshëm, i përkulshëm, i pishëm, i rrjedhshëm, i shkëlqyeshëm, i tretshëm*,

Shënim: Foljet, pjesorja e të cilave del në *-ë*, pothuajse nuk kanë dhënë mbiemra në *-shëm*, përjashtuar këtu rastet *i sjellshëm* (sjellë), *i ngrenshëm* (ngrenë) (kh. *dalë, dhënë, lënë, marrë, vënë, zënë* etj.).

2) tema e foljeve. Edhe në këto formime del po ai problem që shqyrtoam te formimet prejfoljore me prapashtesën *-(ë)s* (pika 13). Ky nëntip e ka zanafillën e vet kryekëput në gegërishten; dhe atje mbiemri ka si temë prodhuese pjesoren e dialektit verior (*punue -i punueshëm*). Duke u shtrirë ky nëntip fjalëformimi në mbarë gjuhën letrare, për arsye të forta semantike, u përgjithësua. Del problemi do të pranohet formimi i këtyre mbiemrave nga tema e foljeve në *-o*, me rënie të *o-së*, dhe me prapashtesën *-ueshëm*, apo do të pranojmë që edhe këtu (si edhe te formimet me *-(ë)s*) kemi formim mbiemrash nga tema e foljes në *-o*, me zërbërthim të *-o-së* në *-ue*, dhe me prapashtesën *-shëm*. Një prapashtesë *-ueshëm* nuk kanë pranuar as A. Xhuvani — E. Çabej, në kudërshtim me pranimin prej tyre të prapashtesës *-ues*; edhe ata pranojnë vetëm prapashtesën *-shëm*. Mendoj, po për ato arsye që u parashtruan tek prapashtesa *-(ë)s*, se është më e drejtë të pranohet edhe këtu zërbërthimi i *-o-së* në *-ue* dhe si prapashtesë të mbahet vetëm *-shëm*, p.sh. *i avullueshëm*, *i çmueshëm*, *i dëshirueshëm*, *i mrekullueshëm*, *i trishtueshëm*. Për foljet me temë në *-ua* duhet pranuar alternimi i grupit zanor *-ua* në *-ue*, p.sh. *shkruaj — i shkrueshëm*, *bluaj — i blueshëm*.

Një pjesë e këtyre formimeve prejfoljore në përdorime të caktuara kanë më tepër kuptim veprues sesa kuptimin e mundësisë a aftësisë, pra janë paralele me formimet me *-(ë)s*, p.sh. *i çuditshëm = çuditës* (njeri *i çuditshëm*), *i habitshëm = habitës* (qëndrim *i habitshëm*), *i trishtueshëm = trishtues* (lajm *i trishtueshëm*) etj.

Disa mbiemra të tjerë të formuar me prapashtesën *-shëm* nga tema foljore tregojnë aftësinë a mundësinë e sendit të karakterizuar prej tyre për të kryer veprimin e emërtuar nga tema prodhuese. Këta mbiemra kanë si tema prodhuese folje kalimtare veprore por edhe jokalimtare (*i bezdisshëm*, *i kënaqshëm*, *i mërzitshëm*, *i kushtuzshëm*, *i rrjedhshëm* etj.). Në të vërtetë ky nëngrup është shumë i afërt me nëngrupin e parë.

Pjesa tjetër e këtyre mbiemrave prejfoljorë tregon aftësinë, mundësinë, meritimin, domosdoshmërinë e pashmangshmërinë e sendit të karakterizuar për t'ju nënshtruar veprimit të emërtuar nga tema prodhuese, p.sh. *i admirueshëm*, *i besueshëm*, *i dënueshëm*, *i kapshëm*, *i lavdërueshëm*, *i mendueshëm*, *i përkulshëm*, *i rrotullueshëm*, *i thyeshëm*, *i zbatueshëm*. Siç shihet nga kuptimi i tyre, në formimin e mbiemrave të nëngrupit të fundit marrin pjesë folje veprore, pësore, mesore e jokalimtare (Për semantikën e mbiemrave të formuar me prapashtesën *-shëm* dhe me paranyjëzim shih edhe artikullin e P. Haxhillazit, cituar në hyrje të këtij punimi).

Shënim 1: Duhet mënjanuar përdorimet e gabueshme me *-shëm* në vend të mbiemrave të formuar nga paranyjëzimi i pjesores: sy të *gëzueshëm*, zë *i gëzueshëm*, *i trishtueshëm* etj. Këta mbiemra kanë kuptim vepror dhe nuk mund të përdoren në ndërtime të tilla, ku duhen mbiemra që tregojnë gjendje (sy të *gëzuar*, zë *i trishtuar* etj.).

Shënim 2: Nga ana tjetër, duhet të mënjanohen nga gjuha letrare përdorimet ende mjaft të shpeshta të mbiemrave të prejardhur me anë të paranyjëzimit të pjesores, me vlerën semantike të mbiemrave me *-shëm*, në të mirë të këtyre mbiemrave të përgjithësuar me *-shëm*. Në toskërishten popullore, në toskërishten letrare gjatë Rilindjes e bile mjaft shpesh edhe në atë të ditëve tona kuptimi i mbiemrave në *-shëm* është dhënë me anë të mbiemrave nga paranyjëzimi i pjesores (pa ndonjë prapashtesë) (kh. kurse natën në Gjirokastër ka errësim të *detyruar*... men-

dova se si erdhi kjo kohë e rëndë që të ketë errësim të *detyrushëm* — I Kadare: Gjenerali, 72). Kështu haset shpesh në vend të *i mundshëm* — *i mundur*, *i lavdërushëm* — *i lavdëruar*, *i papërtueshëm* — *i papërtuar*, *i pavdekshëm* — *i pavdekur* etj. Por në shqipen e sotme letrare këtu nuk është më fjala për variant forme, por për dy mjete që sjellin një ndryshim themelor kuptimor: *i mundshëm* = «mund të ngjasë, mund të ndodhë; mund të mundet», kurse *i mundur* = «që është mundur», pra mbiemri i dytë jep gjendjen e sendit në çastin e karakterizimit nga ky mbiemër. Kështu janë kuptimisht gabim ndërtime të tilla «Populli vietnamez është *i pamundur*, *i pamposhtur*, *i papërkulur*, *i paepur* etj.», sepse kuptimisht këto janë të pasakta, të pamjaftueshme, lënë mundësinë të *mundet*, të *mposhtet*, të *përkulet*, të *epet* në të ardhmen, kurse folësi a shkruesi dëshiron të shprehë idenë që «Populli vietnamez është *i pamundshëm*, *i pamposhtshëm*, *i papërkulshëm*, *i paepshëm*». Është e vërtetë që toskërishtja e ka ngërthyer edhe këtë kuptim në formimet me parayjëzimin e pjesores, por përderisa ekziston mundësia e diferencimit me dy fjalë të ndryshme të këtyre dy kuptimeve leksikore krejt të ndryshme, mbiemrat me *-shëm* duhet të shtrihen e të përgjithësohen gjithandej në përdorimet përkatëse.

Shënim 3: Siç vërejnë A. Xhuvani — E. Çabej (vep. e cit. 85), nga një kryqëzim i prapashtesës *-shëm* me mbaresën e pjesores *-ur* ka dalë një variant prapashtese *-shur* e *-çur* (*i dhëmshur*, *i mënçur*).

2.4. Mbiemra të prejardhur me anë të paranyjzimit, parashtesimit e prapashtesimit njëherazi.

Siç vëren me të drejtë Sh. Demiraj (vep. e cit., I, 84), kjo mënyrë fjalëformimi në shqipen e sotme letrare (e në shqipe në përgjithësi) është shumë e kufizuar në lëmin e formimit të mbiemrave. Në këtë tip fjalëformimi merr pjesë vetëm parashtesa për dhe prapashtesat *-ëm*, *-të* e *-shëm*. Si tema prodhuese shërbejnë tema emërore, p.sh. *i përbotshëm*, *i përceptë*, *i përfaqhtë*, *i përfushtë*, *i përballshëm*, *i përmoortë*, *i përpihtë*, *i përvaishëm*, *i përzjarrshëm*; nga tema përemërore, p.sh. *i përgjithshëm*, *i përveçëm* (<*i përvetëshëm*) dhe nga tema ndajfoljore, p.sh. *i përbashkët*.

2.5. Mbiemra të prejardhur me anë të paranyjzimit.

Në gjuhën shqipe nyja e përparme e mbiemrave, veç rolit gramatikor që luan te mbiemrat e nyjshëm, si një formant që tregon gjininë, rasën e numrin e mbiemrit (dhe që bën përshtatjen me emrin përkatës që karakterizohet nga mbiemri i dhënë), shumë dendur luan edhe rol fjalëformues. Nga pjesë të ndryshme të ligjëratës shpeshherë janë krijuar mbiemra pa asnjë mjet tjetër morfologjik, vetëm me anë të nyjës së përparme. Në këto formime marrin pjesë në radhë të parë tema foljore. Në gjuhën shqipe ka një numër jashtëzakonisht të madh mbiemrash të prejardhur me anë të paranyjzimit të pjesores së foljeve. Pothuaj nga çdo pjesore mund të formohet një mbiemër i tillë, p.sh. *i afruar*, *i besuar*, *i dalluar*, *i fejuar*, *i kaluar*, *i mejtuar*; *i bindur*, *i çelur*, *i dashur*, *i këputur*, *i mbajtur*, *i nisur*, *i vdekur*, *i zgjedhur*, *i lyer*, *i rrëmbyer*, *i shkëlqyer*, *i vëjyer*,

i zbërthyer; i dalë, i ndjerë, i pëgërë, i vënë, i zënë etj. (kh historiani *i dëgjuar* është njeri *i dalë* — Q. Buxheli Karjera, 40).

Të gjithë këta mbiemra nga pjesorja, ndryshe nga ata që formohen me prapashtesën -(ë)s, kanë kryesisht kuptim pësor (pasiv), tregojnë një gjendje të arritur nga sendi i karakterizuar prej tyre, përfundim veprimi të foljes që shërben si temë prodhuese për ta. Por, siç vëren edhe Sh. Demiraj (vep. e cit., I, 84), disa nga këta mbiemra në varësi nga konteksti ku bëjnë pjesë, mund të jenë herë veprorë e herë pësorë, p.sh. *i afruar* (= që afrohet, që është afër; që afron), *i dëgjuar, i ditur, i duruar, i dhënë, i futur, i kuptuar, i qeshur, i gjendur, i kënduar, i hedhur* etj. Bile në ndonjë rast të veçantë mbiemri mund të ketë vetëm kuptim vepror, p.sh. mbiemri *i pasur* = «që ka».

Pra këta mbiemra në të njëjtën formë ngërthejnë të dyja kuptimet, e këtu nuk është fjala për ndonjë shpërdorim të toskërishtes popullore apo edhe letrare, por për një specifikim (së paku në gjendjen e sotme të gjuhës letrare) gati të pazëvendësueshëm të këtyre mbiemrave edhe nga ana leksikore (kh. Ai është *i dhënë* pas muzikës; të bëhi... të mirë e të kuptuar — N. Frashëri; HeS, 35; u mblodhë shumë të ditur — N. Frashëri: Iliadhë, 10).

Nga ana tjetër, duhet shënuar se mbiemrat e formuar nga pjesorja vetëm në përdorime të caktuara kanë vlerë të përfunduar mbiemërore, kurse kur përdoren në funksionin e cilësorit të veçuar ose edhe të cilësorit të drejtpërdrejtë, por të shoqëruar nga rrethanorë të ndryshëm, nga ana semantike janë më afër pjesores, pra, megjithëse përshtaten në të gjitha kategoritë me emrin përkatës, për hir të origjinës së tyre foljore, kanë më fort kuptim foljor, sesa të një tipari. Për këtë flasin qartë edhe marrëdhëniet e tyre sintaksore, p.sh. *Ish lodra e parë në jetë, një lodërzë instiktive, e ruajtur për njeriun që i shfaqti më tepër dashuri* (J. Xoxa: Lumi, III, 254); *Fshatarët e mbledhur në shtëpinë e Pilo Shpiragut, u ndanë atë natë më dysh* (Po aty, I, 139). Pra tjetër semantikë është në përdorimet: Njeri *i ditur*, djalë *i hedhur*, ditë *e shkëlqyer* etj., dhe tjetër në: Lajm *i ditur* nga të gjithë; Mbeturina *të hedhura* në kosh; Pllakë *e shkëlqyer* nga të fërkuarit etj.

Shënim 1: Në këtë nëntip fjalëformimi ka edhe ndonjë formim analogjik, si *i skamur, i kulturuar, i talentuar*, të cilët nuk kanë si temë prodhuese një pjesore, sepse foljet përgjegjëse në gjuhën shqipe nuk ekzistojnë fare, p.sh. Lili ishte një vajzë e bukur dhe e kulturuar (S. Xhai: Qyteti, 280).

Shënim 2: Përsa i përket anës leksikore të këtyre mbiemrave, vlen të theksohet se me këta në një varg rastesh plotësohet kuadri i tri vlerave semantike që mund të jepen me anë mbiemrash, p.sh. *i njomë — njomës — i njomur, i thatë — tharës — i tharë* etj. (mbiemrat *i njomë, i thatë* japin një tipar neutral, si gjendje; *njomës, tharës* kanë kuptim vepror; ndërsa *i njomur, i tharë* kanë kuptim pësor).

Shumë prodhimtare është kjo mënyrë formimi e mbiemrave edhe kur si temë prodhuese shërbejnë togfjalësha *parafjalë + emër*. Këta togfjalësha janë deri diku të qëndrueshme dhe kanë përdorim edhe sot e gjithë ditën krahas mbiemrave përgjegjës (p.sh. Po kjo vjen nga padija, zoti postkomandant. Njeri *pa shkollë*... — Q. Buxheli, Karjera, 194). Si temë prodhuese këtu shërben togfjalëshi i përngjitur *parafjala pa + emër në rasën kallëzore të pashquar*, p.sh. *i paanë, i papunë, i pashkollë, i pashpirt* etj. Këta mbiemra tregojnë mungesën e sendit që përbën temën

prodhuese të mbiemrit përkatës, nga sendi i karakterizuar prej tyre. Këta nuk kanë antonime përgjegjëse mbiemërore si tipi parashtesor *i pa-anshëm* — *i anshëm*, por një togfjalësh emëror me parafjalën *me*: *i pashkollë* — *me shkollë*, *i pander* — *me nder*. Ky tip mbiemrash semantikisht është paralel me formimet me parashtesën *pa-* nga tema mbiemërore me prapashtesën *-shëm*; bile në një pjesë të mirë të tyre këta të fundit po i zëvendësojnë të parët (*i pander* — *i pandershëm*, *i pashijë* — *i pashijshëm* etj.).

Nga paranyjëzimi dhe përngjitja e togjeve parafjalore janë formuar edhe mbiemrat *i paraçlirimit*, *i paraluftës*, *i pasçlirimit* dhe *i pasluftës*.

Një numër mbiemrash formohen, sidomos në gjuhën e folur popullore, nga paranyjëzimi i disa temave emërore, p.sh. *i balë*, *i limë*, *i sorrë*, *i tinë*, *i valë*, *i vlerë* etj.

Po me anë të paranyjëzimit formohen edhe disa mbiemra nga tema ndajfoljore, nga ndajfolje cilësore, vendi e kohe, p.sh. *i afër*, *i çiltër*, *i tatëpjetë*, *i shumë*, *i vonë*, *i verbër*.

3. Mbiemra të formuar me anë të konversionit.

Me formim mbiemrash me anë të konversionit kuptohet formimi i mbiemrave nga pjesë të tjera të ligjëratës pa ndërhyrjen e ndonjë afiksi a alternimi fonetik; pra të dyja fjalët (prodhuesja dhe e prodhuara) janë homonime midis tyre, ato dallojnë vetëm nga paradigmatika e tyre. Këtej del se në këtë tip fjalëformimi nuk merr pjesë as afiksimi, as paranyjëzimi.

Në gjuhën shqipe me anë të konversionit formohen mbiemra vetëm nga klasa e emrave dhe nga disa ndajfolje shumë të vjetra. Emrat, prej të cilëve janë formuar mbiemrat mund të jenë fjalë të parme ose të prejardhura. Këtu hyjnë fjalë që tregojnë banorin apo shtetasin e një vendi (*arbërësh*, *austriak*, *beratas*, *bullgar*, *dibëran*, *durrësak*, *elbasanas*, *fshatar*, *fusharak*, *frëng*, *gjerman*, *korçar*, *malësor*, *pogradecar*, *rus*, *shkodran*, *vlonjat* etj.), ose fjalë që janë emërtime personash sipas mjeshtërisë ose sipas një vetie a tipari karakteristik të tyre (*dorac*, *mëmë*, *motër*, *vëlla*, *mik*, *nënë*, *shok*, *përtac*, *burracak*, *frikacak*, *endacak*, *morracak*, *vocërrak*, *rrugaç*, *dinak*, *çalaman*, *fjalaman*; *frikaman*, *leckaman*, *fisnik*, *plak*, *pasanik*, *prapanik*, *vërsnik*, *shkatërraq*, *gënjeshtar*, *frikash*, *gjumash*, *morrash*, *qurrash*, *ndihmës*, *paraardhës*, *punonjës*, *vartës*, *komunist*, *marksist*, *trim*, *grabitqar*, *këngëtar*, *luftëtar*, *moshatar* etj.)⁶⁷ ose fjalë që emërtojnë sende me tipare karakteristike që abstragohen lehtë: *kyç*, *bazë*, *kukull*, *shtazë*, *gështenjë* etj. Për ta bërë më të qartë këtë kalim të emrave në mbiemra, po japim disa shembuj, ku këto fjalë janë përdorur herë si emra e herë si mbiemra, p.sh. u përplas me një *bukurosh* (M. Kallamata, I fundit, 5); kavalierët *bukuroshë* (po aty, 22); Le ai, *trashaluqi*: E hiqte veten si politikan (po aty, 71); para një gruaje *trashaluqe* (po aty, 6); Le të të qëllonte, *burracak* (Q. Buxheli, Karjera, 117); bujarët e atij vendi

67) Këtu vlen të mbahet parasysh vërejtja shumë e drejtë e K. Cipos, vep. e cit. 41-42, mbi prapashtesat *-ar*, *-tar*, *-ës*, *-ist*, *-ik*, *-tor*, *-it*, *-as*, *-an*, *-ak*, *-njan*, *-at*, *-arak*, *-ash*, *-osh*, *-ac*, *-njar*, *-rash*, *-a-cak*, *-a-njos*, *-ec*, *-ok* si prapashtesa mjeshtërie profesioni, zejtarie, nëpunësie, veglash e emrash pejorativë që tregojnë një të metë trupore. Shih edhe vërejtjet në hyrje të këtij punimi për këtë pikëpamje të K. Cipos dhe për parashtrimet e V. Dançetoviqit.

M. Kuteli, Tregime, 18); një djalë i pashëm, *bujar* (po aty, 26); *Besnikët* thirrë (Q. Buxheli, Karjera, 77); o lajmëtar *besnik* (M. Kuteli, Tregime, 221); *trimi* u kthye (po aty, 43); janë gjahtarë *trima* (po aty, 76); *tregëtarit* grosist (M. Kallamati, I fundit, 37); allishveriset e tij *tregëtare* (po aty, 32); thonë që jam *budalla* i madh (Q. Buxheli, Karjera, 186); gomari nuk është aq *budalla* (po aty, 186); familja e një *komunisti* (M. Kallamata, I fundit, 127); një parti *komuniste* (Q. Buxheli, Karjera, 209); moj *korçare* e bukur (M. Kallamata, I fundit, 100); këngë *korçare* (po aty); Italinë *fashiste* (po aty, 201); Italisë *mike* (po aty, 199); shtetit *mik* (po aty, 249); *çamarrokja* ime (po aty, 221); fëmijëve *çamarrokë* (po aty, 87); gjenin be-lanë nga *rrugaçët* (po aty, 67); në radhët e para *leckamanët* (po aty, 101); u ngritën *reckamanët* (M. Kallamata, I fundit, 57); më je më *armik* nga gjithë mbretëret (N. Frashëri: HeS, 29); Po kush je ti, kaq i afër e kaq i largët, kaq *mik* e kaq *armik* (J. Xoxa: Novela, I, 155); për Partinë Komuniste *motër* të Kinës (E. Hoxha: 20 vjet, 35); ne jemi të bindur dhe të sigurtë në fitoren e çështjes së popullit *vëlla* vietnamez (po aty, 38); në rend të ditës si probleme *kyçe* dalin çështja e qëndrimit ndaj Stalinit (Tradhëtarët, ZP, 22.III.1966, 4); ushtarët *kukulla* ngrejnë krye... Trupat *kukulla* ngritën shpejt e shpejt barrikada (Gjendje, ZP, 5.IV.1966, 4); krejt *shtazë* asht e shkreta (K. Floqi: Nder, 24); duke iu përmbajtur rreptësisht kriterëve *bazë* (Fjala e sh. M. Shehu, Puna, 18.III.1966, 2); pamë dhi-mbjen e madhe të tokës *nënë* (N. Jorgaqi: DeM, 60).

Sikurse është theksuar edhe te formimet e ndryshme prapashtesore, pikërisht në ndikimin e këtyre fjalëve që me anë të konversionit kaluan nga emra në mbiemra, për analogji me tipin fjalëformues të tyre, prapashtesat përkatëse të këtyre fjalëve janë bërë prodhimtare (sigurisht në masë të ndryshme) edhe në klasën e mbiemrave, duke formuar drejtpërsëdrejti mbiemra nga pjesë të ndryshme të ligjëratës.

Ndajfoljet që kanë kaluar edhe në mbiemra me anë të konversionit, janë ndajfoljet e formuara me prapashtesat *-çe* dhe *-ishte*, si edhe disa të tjera të formuara nga togje emërore të ndërhuara me anë të përsëritjes së të njëjtit emër, p.sh. *derrçe*, *fshaçz*, *hajduçe*, *lapçe*, *vëndçe*; *burrërishte*, *grarishte*; *lara-lara*, *ngjyra-ngjyra*, *kllapa-kllapa*, *lule-lule*, *vëra-vëra*; *male-male*, *togje-togje*, *flokë-flokë*, *rrecka-rrecka*, *copë-copë*, *unazë-unazë*, *katrore-katrore*, *rruaza-rruaza*, *çikë-çikë*, *radhoj-radhoj*, *vergje-vergje*, *fi-e-fije*, *pika-pika*, *palë-palë* etj., p.sh. një këngë *vënçe* (M. Kallamata, fundit, 155); britmën *grarishte* (M. Kuteli; Tregime, 127); mori një këngë *pleqërishte* (S. Godo: Zëra, 17); veshur me rroba *hajduçe* / veshur me rroba *çobançe* (Visaret e kombit, V, 137); sa për rrobat e mija *marinarçe* dhe këpucët e bardha, më mirë mos pyesni (Dh. Shuteriqi: Gurnecka, 75); Pa zot mulliri, si gjë *fshaçe* që ishte (M. Zaloshnja: Mendja, 184); ajo hyn në vorreza me hapa *hajduçe* (N. Bulka: Skica, 22); mbuluar... me qilima *lule-lule* që të lëbyrin sytë (J. Xoxa: Lumi, I, 188); me ca petka *vëra-vëra* (Çajupi: Vepra, 297); Troj'e shkretë *male-male* (po aty, 152); del një shtrigë *rrecka-rrecka* (Xh. Bilbili; Skena, 28); një bishë me lëkurë *katrore-katrore* (I. Kadare: Përbindshi, 51); me fustane *tumbë-tumbë* (Mbledhës, III, 94); pushk'e Matës *lara-lara* (po aty, II, 159); Mike, kur të kujtoj, Gushënë *radhoj-radhoj* (po aty, 110) etj.

Të gjithë këta mbiemra nuk pësojnë asnjë ndryshim forme (pra nuk ndryshojnë as në gjini e as në numër; përsa i përket rasës, gjithë mbiemrat e panyjshëm në prapavendosje nuk e kanë këtë kategori).

4. Mbiemra të përbërë.

Si përkufizim i fjalës së përbërë e rrjedhimisht edhe i mbiemrit të përbërë, këtu do të pranohet ai i A. Kostallarit, sipas të cilit «Fjalë e përbërë ose kompozitë e mirëfillët në shqipen është ajo fjalë *dygjymtyrëshe* që formohet nga bashkimi i dy a më shumë *temave* në një fjalë të vetme, në një njësi të vetme leksiko-semantike strukturalisht të mbyllur, e cila formësohet si një tërësi e pavarur fonetiko-morfologjike, ka kategoritë e veta potenciale fjalëformonjëse, zhvillohet semantikisht dhe kryen funksionet e veta gjithnjë si një tërësi-fjalë, pavarësisht nga veçoritë fonetike dhe leksiko-gramatikore të komponentëve të saj»⁶⁸. Siç del edhe nga studimi i A. Kostallarit, kjo mënyrë fjalëformimi është mjaft e vjetër e mjaft prodhimtare në gjuhën shqipe edhe për klasën e mbiemrave. Këtu dallohen dy nëntipe kryesore: a) mbiemra të përbërë me lidhje bashkërenditëse dhe b) mbiemra të përbërë me lidhje nënrenditëse. Nga shqyrtimi i mbiemrave të përbërë në gjuhën shqipe, del se ata formohen zakonisht nga bashkimi i dy (por në disa raste më pak të rëndomta edhe tri) temave.

4.1. Mbiemra të përbërë me lidhje bashkërenditëse.

Ky nëntip fjalëformimi është bërë shumë prodhimtar sidomos në shqipen letrare të kohëve të fundit. Si tema prodhuese këtu shërbejnë dy (ndonjëherë edhe tre) mbiemra, të cilët janë të barazvlershëm si për sa i përket mëvetësisë semantike ashtu edhe asaj sintaksore; ata as varen nga njëri-tjetri, as përcaktojnë njëri-tjetrin, por vetëm deri diku plotësojnë njëri-tjetrin reciprokisht (*agraroindustrial, amerikanojaponez, anglo-amerikan, estetikoshkencor, historikogjeografik, historikokultural, indianopakistanez, ideopolitik, italogjerman, japonojugkorean, materialoteknik, moralopolitik, politikoekonomik, sovjetoamerikan, sovjetoshqiptar, teknikoshkencor* etj.

Shënim: Ndonjëherë ndodhin dhe shkurtime në elementin e parë të kompozitës p.sh. *afroaziatik* (për *afrikanoaziatik*), *feudoborgjez* (për *feudaloborgjez*), *venetoshqiptar* (për *venetikoshqiptar*) etj.

Në ndonjë rast në marrëdhënie të tilla bashkërenditëse mund të hyjnë më se dy tema mbiemërore, p.sh. *sovjetoangloamerikan, fetarobejlerotregëtar* etj. (p.sh. Po nuk duruan dot kur panë veturën e komisionit *fetaro-bejlero-tregëtar* të parisë së Fierit (J. Xoxa, Lumi II, 197). Mbiemrat e bashkërenditur kanë barazi e pavarësi funksioni, prandaj edhe lidhja midis tyre është më e dobët sesa tek tipi me lidhje nënrenditëse. Kuptimi i mbarë kompozitës këtu është afërsisht i barabartë me shumën e kuptimeve të mbiemrave përbërës. Zanorja *o* e këtyre kompozitave, megjithëse ende nuk është përgjithësuar gjithandej (kh. nevojat *aktuale-politike* — Drita, 4.II.68, 2; kuadrit *mësimor shkencor* — Ylli, Nr. 10, 1967, 9; *rëvolucioni demokratik-borgjez* — I thjeshtë etj.), luan rolin e

68) A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në BUSHT, SShSh, 3/1961, 12. Edhe për shtjellimin semantik e leksikologjik të tyre referojmë në këtë artikull dhe në artikullin tjetër të po këtij autori: *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, në BUSHT, SShSh, 3/1962, 3v.

një mjeti lidhës fjalëformues, prandaj edhe vendosja në shkrim e vizës midis tyre, gjë që flet për mëvetësinë relative të elementëve përbërës të këtyre kompozitave (punë *tekniko-shkencore* = punë *teknike e shkencore*), nuk mund të përliqet, këta mbiemra duhen shkruar si një fjalë e vetme, pa vizë midis.

4.2. Mbiemra të përbërë me lidhje nënrenditëse.

Edhe ky nëntip fjalëformimi është gjithashtu mjaft prodhimtar në gjuhën shqipe. Veçori e këtij nëntipi është karakteri përcaktor i njërit prej elementëve të fjalës së përbërë; pra, elementët përcaktojnë njëri-tjetrin, duke saktësuar, konkretizuar e ngushtuar njëri-tjetrin nga pikëpamja e kuptimit. Njëri nga elementët e kompozitës, herë i përcaktuari e herë përcaktuesi, emërton një nocion më të gjerë sesa mbarë kompozita mbiemërore. Elementi përcaktues mund të jetë elementi i parë ose i dytë. Këta mbiemra quhen edhe kompozita pronësore.

Sipas temave prodhuese që marrin pjesë në formimin e këtyre mbiemrave, dallohen mbiemra të përbërë nga: 1) dy tema emërore; 2) një temë emërore dhe një mbiemërore; 3) dy tema mbiemërore; 4) një temë emërore e një ndajfoljore ose anasjelltas; 5) një numëror (a përemër i përcaktuar) dhe një mbiemër; 6) një numëror (a përemër i pacaktuar), një emër dhe sufiksi *-sh*. 7) Përemri vetvetor *vetë* dhe një emër vepruesi.

4.2.1. Mbiemra të përbërë nga dy tema emërore.

Përsa i përket karakterit përcaktor të elementëve përbërës të këtyre lloj kompozitave këtu dallohen dy nëngrupe: 1) elementi i dytë përcakton të parin dhe 2) elementi i parë përcakton të dytin.

Mbiemrat e përbërë nga dy tema emërore që kanë si element përcaktor elementin e dytë, emërtojnë tiparin jo drejtpërsëdrejti por në mënyrë të ndërmjetuar, nëpërmjet krahasimit të një pjese të sendit të karakterizuar me një send tjetër, duke i atribuuar (veshur) asaj një nga tiparet dalluese të këtij sendi (*bishtcung, gushpëllumb, hundësqep, hundëshkabë, kokëderr, kokëkungull, mjekërcjap, sygrifshë, sylugat, shpirtkazmë, vetullSORRË, zemërlepur, zemërkrund-e-gërdhu*). Siç del nga shembulli i fundit, tipari i pjesës së sendit të karakterizuar nga mbiemri i përbërë mund të jepet përmes krahasimit jo vetëm me një send por edhe me dy sende të tjera. Ky nëntip është mjaft prodhimtar veçanërisht në gjuhën popullore dhe në prozën artistike shqipe dhe e ka burimin e tij te krahasimi (*gërshetëdegë* = që i ka gërshetat si degë — bile shpesh mund të zërthehet lehtë në një fjali a togfjalësh të tillë). Te kjo mënyrë kompozimi origjinarisht duhet të kemi pasur përngjitje fjalësh, në gjuhën popullore edhe sot thuhet: e ka *kokën mur, kokën shkëmb, syrin pishë*, etj. Ka raste të veçanta, ku si bazë për formimin e mbiemrit nuk shërben krahasimi (*sylesh* = sy të zënë me lesh, *buzëgaz* = buzën në gaz, me buzë në gaz; *hundëqurre* = që i ka hundët me qurre; *këmbëlesh* = që i ka këmbët me lesh etj.).

Mbiemrat e këtij nëntipi, megjithëse në dukje e shprehin tiparin në mënyrë të ndërmjetuar, ndryshojnë rrënjësisht nga gjithë mbiemrat e tjerë të ndërmjetuar për vetë semantikën e tyre. Këta mbiemra, ashtu si

gjithë mbiemrat e përbërë, emërtojnë një tipar cilësor të vetëm që i vihet drejtpërdrejt çdo sendi të karakterizuar prej tyre dhe që shpreh një shumë tiparesh të emërtuara nga temat prodhuese. Në këtë pikëpamje këta janë të ngjashëm me kuptimin figurativ të mbiemrave të ndërmjetuar. Te këta ruhen deri në një farë mase nuancat kuptimore e sintaksore të sintagmave përcaktore përkatëse. Cilësimi i sendit të karakterizuar nga këta mbiemra bëhet, siç u tha, duke u cilësuar një pjesë e këtij sendi (*kokëshkëmb* = që e ka kokën (si) shkëmb).

Nëntipi i dytë, kur elementi i parë përcakton të dytin, është bërë më prodhimtar në gjuhën letrare, por burimin e vet edhe ky e ka në gjuhën popullore, siç vëren me të drejtë Sh. Demiraj (vep. e cit., 1, 85). Elementi i parë (përcaktuesi) është një emër çfarëdo, kurse i dyti (i përcaktuari) është një emër vepruesi, p.sh. *hakmarrës, jetëdhënës, lirisdashës, lotsjellës, mishngrënës, naft-e-gazmbajtës, zjarrfikës, atdhemohonjës, vetvrasës, epshkapërthyes, turp-endotkundërmonjës, mirënjohës* etj., p.sh. do të japë perspektivën *gaz-naftë-mbajtëse* të saj (ZP 26.II.66, 3).

Shënim: -e-ja te mbiemrat e tipit *zemërkrund-e-gërdhu, turp-e-ndotkundërmonjës, dor-e-këmbargjendë* etj., megjithëse ndjehet ende qartë si mjet lidhës i elementëve të kompozitës dhe përdoret për të evituar përsëritjen, për të mos thënë *zemërkrunde e zemërgërdhu, dorargjendë e këmbargjerde* (kh. gjerm. *Hals-und Beinbruch, Haus-und Klassenübung, Sport-und Erholunosplatz* etj.) prapëseprapë ajo ka fituar tashmë vlerën e një morfeme fjalëformuese⁶⁹ (për këtë mjafton të kemi parasysh mbiemra të tillë të substantivuar); nga ana tjetër, këta mbiemra duhen shkruar siç u shkruan më sipër e jo siç hasen në letërsinë artistike (pra jo *zemër-krund-e-gërdhu, turp-e-ndotkundërmonjës, dor' e këmb' argjendë, gaz-naftë-mbajtëse* etj., por *zemërkrund-e-gërdhu, turp-e-ndotkundërmonjës, dor-e-këmbargjendë* etj. e ndoshta-ndoshta edhe këtu viza duhet mënjanuar fare.).

4.2.2. Emra të përbërë nga një temë emërore dhe një temë mbiemërore.

Një studim shumë i hollësishëm për këtë nëntip fjalëformimi është ai i A. Kostallarit (Kompozitat ekzocentrike... 3/1962, 3v). Ky nëntip është një nga më prodhimtaret. Si element përcaktues në këto kompozita shërben elementi i dytë, tema mbiemërore, ndërsa elementi i parë përbëhet nga një emër çfarëdo që emërton një pjesë përbërëse të sendit të karakterizuar nga kompozita e dhënë, ose një send çfarëdo që në një mënyrë ose në një tjetër lidhet me të, p.sh. *ballëhapët, barkgjerë, belhollë, dorë-mbarë, gojëprishur, flokëverdhë, kokëmadh, cipëplasur, derëbardhë, ditë-gjatë, dritëshkurtër, fatbardhë, fije-hollë, fjalëmbël, fuqimadh, gojëndyrë, hundështypur, kokëprerë, shpirtzi, zemërkeq, zemërzi*, etj.

Kjo mënyrë fjalëformimi është jashtëzakonisht prodhimtare në gjuhën shqipe, sidomos në mbiemra që përdoren për të karakterizuar njerëz, por nuk mungojnë rastet edhe për frymorë të tjerë ose edhe për jofrymorë, por si përdorim mbizotëron përdorimi predikativ në krahasim me atë atributiv.

69) A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë...*, 3/1961, 13.

Tipari i pjesës së sendit të karakterizuar emërtohet drejtpërsëdrejti. Përveç këtij dallimi, këtu vlejné po ato vërejtje të përgjithshme që u bëné për mbiemrat e përbërë nga dy tema emërore; pra, tipari shprehet si shumë tiparesh të emërtuara nga tema prodhuese, ruhen gjer në një farë mase nuancat kuptimore e sintaksore të sintagmave përgjegjëse, cilësimi i sendit bëhet përmes emërtimit të caktuar të atij sendi (a të një sendi çfarëdo që në një farë mënyre lidhet me atë send).

Shënim: Lidhëza *-e-* në rastet kur si tema prodhuese shërbejnë tri tema (dy tema emërore dhe një mbiemërore), edhe këtu ka marrë vlerë fjalëformuese, megjithëse e ruan ende të qartë funksionin e saj si mjet lidhës (ashtu si në rastin e lartpërmendur), p.sh. *Myzeqarka, kokë e sy mbërdhe* (J. Xoxa, Lumi, III, 157); kjo ishte vajzë nja 16 vjeçare, *sy e vetull zezë* (H. Stërmilli; Sikur, 114); *Hajrija... flokë e mend çprishur* (J. Xoxa, Lumi, III, 73); *Po sa Lenka kemi njohur ne, ashtu të vogla, flokë e sy zeza* (Z. P., 9.III.1966, 1). Edhe këtu duhet theksuar drejtshkrimi i këtyre kompozitave: ose *kokë-e-symbërdhe*, *sy-e-vetullzezë*, *flokë-e-syzezë*, ose pa vizë fare midis tyre.

4.2.3. Mbiemra të përbërë nga dy tema mbiemërore.

Ky nëntip fjalëformimi është shumë pak prodhimtar dhe mund të thuhet se është më fort pasojë e kalkimit nga gjuhët e huaja. Në këtë nëntip njëri mbiemër përcakton tjetrin, kurse ndaj fjalës së karakterizuar i tërë mbiemri kompozitë ka një vlerë të vetme të pazbërthyeshme, p.sh. *gjermanolindor, gjermanoperëndimor, jugvietnamez, koreanojugor, veriirlandez, irlandezoverior, vietnamezojugor*. Siç shihet edhe nga shembujt e mësipërm, nuk ka një rend të ngulitur përsa u përket elementëve përbërës të kompozitës, herë shërben elementi i parë si përcaktues i të dytit e herë anasjelltas. Mendoj se do të ishte më e drejtë që si element përcaktues të ishte elementi i dytë, i cili ka mundësi të përgjithësohet në mbarë formimet e mundshme. (Kh. këtë lëvizje gjithnjë në rritje të popullit *koreano-jugor* — Z.P. 27.II.72, 4; ky është personaliteti i dytë i lartë *irlandezoverior* — Z.P. 24.II.72; patriotët *jugvietnamezë* — Z.P. 27.II.72; patriotët *veriirlandezë* — Z.P. 15.II.72).

Zanorja *-o-* këtu luan rol fjalëformues, të dy mbiemrat shkrihen plotësisht në një fjalë të vetme të pazbërthyeshme (*koreanojugor* = *korean jugor*).

4.2.4. Mbiemra të përbërë nga një temë ndajfoljore dhe një emër ose anasjelltas.

Edhe ky nëntip është pak prodhimtar dhe jo aq popullor. Për variantin e parë si tema prodhuese shërbejnë një temë ndajfoljore çfarëdo dhe një emër vepruesi (*keqdashës, largpamës, largvajtës, mirëbërës*). Elementi përcaktues i kompozitës është elementi i parë.

Shënim: Hasen disa raste me rend të përmbysur të elementëve përbërës, p.sh. *dashamir-(ës), dashakeq, bamirës, bakeq, ngrënëkeq* etj. Vendosja e prapashtesës *-ës* pas këtyre formimeve nuk përlligjet në gjuhën letrare. Në përgjithësi duhet parapëlqyer rendi më i zakonshëm *ndajfolje + emër në -ës*.

Më pak i rëndomtë dhe i kufizuar në disa raste të veçanta është nëntipi i anasjelltë me temë prodhuese një emër dhe një ndajfolje. Tema emërore është gjithmonë një pjesë e sendit të karakterizuar nga kompozita mbiemërore, kurse ndajfolja është edhe këtu elementi përcaktues (*dorëjashtë, kryejashtë, kokëjashtë, hundëpërpjet* etj.) Pikënisja e kësaj mënyre formimi mund të jetë përngjitja.

Shënim: Përsa u përket mbiemrave të tipit: *brigjeshumë, lulëshumë, mendjeshumë, mëshirëshumë, valëshumë, nderëplotë, lavdiplotë, dritëplotë, degëplotë, besëplotë* etj. që kanë bazë popullore, këta nuk zërthehen si mbiemrat e mirëfilltë bahuverihi, por në «me shumë brigje», «me plot nder», «me shumë lule» etj.; pra, në këto kompozita merr pjesë një përemër i pacaktuar dhe një emër.

4.2.6. Mbiemra të përbërë nga një numëror (a përemër i pacaktuar) dhe një mbiemër.

Kjo mënyrë fjalëformimi është mjaft prodhimtare në gjuhën e sotme shqipe. Si tema prodhuese këtu shërbejnë një numëror çfarëdo ose përemrat e pacaktuar *shumë* e *disa*, si element përcaktues, dhe një mbiemër çfarëdo (më rëndom që tregon marrëdhënie kohore), si i pacaktuar (*njëvjeçar, njëditor, njëmuor, dyvjeçar, treqindvjeçar, i njëanshëm, i dyanshëm, i shumanshëm, disavjeçar, disaditor, disamuor* etj.

4.2.7. Mbiemra të përbërë nga një numëror (a përemër i pacaktuar), një emër dhe formanti *-sh*.

Ky nëntip fjalëformimi sa vete e po bëhet më prodhimtar në gjuhën e sotme letrare. Si tema prodhuese këtu shërbejnë një numëror çfarëdo (ose përemrat e pacaktuar *shumë* e *disa*) si element i parë përcaktues i kompozitës, një emër dhe formati *-sh*, i cili, siç vëren me të drejtë A. Kostallari, është prapashtesa trajtëformuese e rrjedhore që «po shndërron në prapashtesë fjalëformuese»⁷⁰, (*njërrokësh, dykatësh, dypalësh, tringjyrësh, shumëngjyrësh, disaballësh, disaditësh, disajavësh, disakatësh* etj.). Edhe këtu në formimet e para është kaluar nga përngjitja në kompozim, sintagma është shndërruar në një fjalë të vetme, pastaj për analogji me këto raste është kaluar në formime fjalësh mbiemërore drejtpërsëdrejti, sipas modelit ekzistues.

4.2.8. Miembra të përbërë nga përemri vetvetor vetë dhe një emër vepruesi.

Ky nëntip fjalëformimi nuk është aq prodhimtar dhe ka një përdorim më të madh në gjuhën letrare. Si element i parë përcaktues shërben përemri vetvetor *vetë*, kurse si element i dytë një emër vepruesi ose një mbiemër (*vetëmbushës, vetëshkarkues, vetëvrasës, vetëdashës, vetëshërbyes* etj.), p.sh. Në maqinat frezuese moderne ka edhe *vetëndaluese*

70) A. Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, BUSHT, SShSh, 3/1961, 11.

(Ll. Xhajanka, Libri, 5); në ballin e frontit të punimeve minerare me lopatë *vetëngarkuese* (G. Shameti, Metodë, 4); Korrja bëhet me drapër, me maqina kositëse ose korrëse *vetëhedhëse* (H. Ahmataj, Kultivimi, 53); çfarë shenjash të *vetëndieshme* (Q. Bakalli, Mjekimi, 15). Duhet mënjannuar nga gjuha letrare rënia e zanores ë të elementit të parë të kësaj kompozite.

P Ë R F U N D I M

Duke i shqyrtuar mbiemrat për nga fjalëformimi i tyre, del se në gjuhën e sotme shqipe ka mbiemra të parmë, të prejardhur, të formuar me konversion dhe të përbërë.

Numri i mbiemrave të parmë në gjuhën shqipe në stadin e sotëm të zhvillimit e të lëvrimit të saj është relativisht i madh. Në këtë grup përfshihen edhe ata mbiemra që kanë hyrë nga gjuhët e huaja, por që nuk mund të zberthehen e të analizohen në elementët e tyre përbërës.

Pjesën më të madhe të mbiemrave të gjuhës shqipe e përbëjnë mbiemrat e prejardhur e brenda këtij grupi vendin e parë e zënë ata që formohen me anë të prapashtesimit, pastaj ata që formohen me paranyjzim dhe me paranyjzim e prapashtesim njëkohësisht.

Një varg mbiemrash janë formuar me anë të parashtesimit. Karakteristike për këtë tip fjalëformimi të mbiemrave është që këtu marrin pjesë vetëm tema mbiemërore. Parashtesat që formojnë mbiemra janë: *a-*, *anti-*, *ç-*, *i-*, *im-*, *in-*, *jashtë-*, *jo-*, *kundër-*, *pro-*, *mbi-*, *mos-*, *ndër-*, *pa-*, *para-*, *për-*, *porsa-*, *prej-*, *sapo-*, *stër-*, *tej-*. Ndër këto parashtesat *i-*, *im-*, *in-* e *kundër-* janë krejt joprodhimtare e të rralla; parashtesat *porsa-*, *sapo* e *prej* nuk kanë shumë që kanë filluar të përdoren në gjuhën letrare, por prodhimtaria e tyre është në rritje. Parashtesa më prodhimtare për formimin e mbiemrave në gjuhën shqipe është paashtesa *pa-*; ndërkaq duhet pranuar që tipi i *pashkollë* është formuar nga përngjitja e paranyjzimi i togfjalëshit parafjalor *pa shkollë*.

Me anë të prapashtesimit në gjuhën letrare shqipe formohen vetëm mbiemra të panyjshëm. Si tema prodhuese në këtë tip fjalëformimi marrin pjesë tema emërore, mbiemërore, foljore e ndajfoljore, por jo në një masë të barabartë. Prapashtesat që formojnë mbiemra, janë: *-ac*, *-acak*, *-acuk*, *-ak*, *-al* (*-ial*), *-an*, *-ian*, *-anik*, *-ar*, *-arak*, *-atak*, *-tar*, *-esh*, *-ëror*, *-(ë)s*, *-ësor*, *-ik*, *-iv*, *-ist*, *-njës*, *-oç*, *-or*, *-osh*, *-oz*, *-tar*; *-tor*; *-uk*, *-ush*.

Prapashtesat më prodhimtare në këtë tip fjalëformimi janë: *-(ë)s* e *-or*. Një pjesë prapashtesash hasen kryesisht në mbiemra që kanë hyrë në gjuhën letrare nga gjuhët moderne (*-al*, *-ial*, *-ian*, *-ik*, *-iv*, *-ist*). Pjesa më e mirë e prapashtesave janë bërë prodhimtare në klasën e mbiemrave nën veprimin e analogjisë, nga mbiemrat që janë formuar me konversion nga emrat përgjegjës.

Me anë të paranyjzimit dhe prapashtesimit njëkohësisht formohet një numër shumë i madh mbiemrash. Në këtë tip marrin pjesë prapashtesat: *-ë*, *-(ë)m(ë)*, *-(ë)t(ë)* dhe *-shëm*. Për nga prodhimtaria e tyre rendi i këtyre prapashtesave duhet përmbysur: *-shëm*, *-(ë)t(ë)*, *-(ë)m(ë)*. Duhet nënvizuar që në formimet me prapashtesën *-t(ë)* duhen

përfshirë edhe mbiemrat e prejardhur nga tema numërore, të cilët deri tani janë mbajtur si numërorë rreshtorë.

Duke e parë çështjen e fjalëformimit vetëm në planin e gjuhës së përbashkët letrare kombëtare, probleme serioze ngrenë formimet me prapashtesat *-(ë)s* e *-shëm*: ç'tema shërbejnë këtu si tema prodhuese për formimet nga foljet me temën në *-o*? Në këtë punim është mbrojtur pikëpamja që në këto raste si temë prodhuese shërben vetë tema e foljes, me *-o* të zërthyer në *-ue*. Meqë tipi me *-shëm* ka një semantikë specifike të dalluar qartë, duhet të gjejë një përhapje të përgjithshme e më të shpejtë në dëm të mbiemrave nga paranyjëzimi i pjesores, kur këta të fundit përdoren në vend të së parës, gjë që është një karakteristikë e toskërishtes.

Tipi më pak prodhimtar në formimin e mbiemrave është ai i prejardhjes me anë të paranyjëzimit, parashtesimit e prapashtesimit njëherazi. Këtu marrin pjesë vetëm parashtesa *për-* dhe prapashtesat *-ëm*, *-të* e *-shëm*.

Me anë të paranyjëzimit formohen gjithë mbiemrat nga pjesorja e foljes pa ndonjë prapashtesë dhe nga përngjitja e togfjalëshit *pa + emër*, si edhe pak të tjerë nga disa mbiemra dhe ndajfolje.

Një tip shumë prodhimtar dhe që ka mbetur pa u trajtuar deri më sot në formimin e mbiemrave të gjuhës shqipe, është konversioni. Me anë të kësaj mënyre janë formuar mbiemra nga emra që tregojnë banorin apo shtetasin e një vendi ose që emërtojnë persona sipas mjeshhtërisë a sipas ndonjë tipari karakteristik të tyre. Me këtë mënyrë formohen edhe disa mbiemra nga ndajfolje shumë të vjetra. Ky tip fjalëformimi mbetet më problemori në formimin e mbiemrave të gjuhës shqipe dhe kërkon një studim më të përqendruar, sepse, pavarësisht nga tipi i përgjithshëm, historia e çdo fjale kërkon të ndiqet veçmas e me kujdes, pasi mund të përbëjë përjashtim nga rregulla, d.m.th. mund të jetë formuar sëpari si mbiemër, pastaj për të kaluar në emër.

Mbiemrat e përbërë paraqesin gjithashtu një grup jashtëzakonisht të pasur fjalësh. Tipi me marrëdhënie bashkërenditëse është karakteristik për gjuhën letrare dhe ka një denduri veçanërisht të madhe në stilin publicistik. Viza që shkruhet midis dy elementëve përbërës të këtyre kompozitave, duhet mënjanuar, sepse rolin e mjetit lidhës këtu e luan zanorja *-o-*.

Tipi me marrëdhënie nënrenditëse ka bazë popullore në gjuhën shqipe dhe njihet disa nëntipe, nga të cilat kryet e vendit e zënë mbiemrat e përbërë nga një temë emërore dhe një temë mbiemërore dhe mbiemrat e përbërë nga dy tema emërore (*kokëmadh; kokëderr*). Këtu zakonisht marrin pjesë dy tema prodhuese, por edhe kur marrin pjesë tri, në të vërtetë dy janë të bashkëngjitura midis tyre e të nënrenditura ndaj së tretës (*dor-e-këmbargjendë, sy-e-vetullzezë*). Më pak prodhimtare janë formimet nga dy tema mbiemërore (*gjermanoperëndimor* — ku në disa raste përbën problem ngulitja e rendit të elementëve përbërës të kompozitës), nga një temë ndajfoljore dhe një emër ose anasjelltas (*keqdashës, barkjashtë*), nga një numëror (a përemër i paktuar) një emër dhe formanti *-sh* (*njëkatësh*) dhe nga përemri vetëvetor *vetë* e një emër vepruesi a mbiemër analogjik me këtë të fundit (*vetëshkarkues*).

Shkurtimet e përdorura në punim

- A. Abdihoqha, Tri, I — Tri ngjyra të kohës, V. I. Tiranë, 1965.
 C. Simoni, Pinoku — Pinoku (përkthim), Shkodër, 1934.
 Çajupi, Vepra — Vepra, Tiranë.
 D. Kurti, Përralla — Përralla kombëtare, I, Shkodër, 1942.
 D. Shaplo, Përtëritje — Përtëritje, Tiranë, 1960.
 D. Agolli, Zhurma — Zhurma e erërave të dikurshme, Tiranë, 1965.
 Dua, I — Dua të di gjithshka, I, 1968.
 E. Hoxha, 20 vjet — 20 vjet Shqipëri socialiste, Tiranë 1964.
 F. Noli, Hamleti — Hamleti (përkthim).
 Don Kishoti — Don Kishoti (përkthim), Boston, 1932.
 F. Gjata, Këneta — Këneta, Tiranë, 1959.
 Përmbysja — Përmbysja, Tiranë, 1955.
 F. Postoli, LeK — Lulja e kujtimit, Tiranë, 1961.
 Për mprojtjen — Për mprojtjen e atdheut, Korçë, 1943.
 G. Shameti, Metodë — Metodë e re në punimet minerare, Tiranë, 1967.
 H. Stërmilli, Sikur — Sikur të isha djalë, Tiranë, 1959.
 H. Ahmataj, Kultivimi — Kultivimi i disa bimëve, Tiranë, 1966.
 I. Kadare, Gjenerali — Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, 1963.
 I thjeshtë — I thjeshtë si e vërteta, Tiranë, 1965.
 J. Xoxa, Lumi, II, III — Lumi i vdekur, Tiranë, 1965.
 Novela, I — Novela, Tiranë, 1949.
 L. Dilo, Lufta AP — Lufta... Arësimi popullor, 1, 1967.
 Ll. Xhajanka, Libri — Libri i punëtorit, Nr. 8, Frezatori.
 Ll. Siliqi, Ringjallja — Ringjallja, Tiranë, 1967.
 M. Kallamata, I fundit — I fundit i oxhakut, Tiranë, 1971.
 M. Kuteli, Tregime — Tregime të moçme shqiptare, Tiranë, 1965.
 M. Zaloshnja, Mendja — Mendja bën kala, mendja bën hata, Tiranë, 1958.
 M. Myftiu, Leka — Leka, Tiranë, 1960.
 N. Frashëri, HeS — Histori e Skënderbeut, Korçë, 1923.
 Iliadhë — Iliadhë e Omirit, Bukuresht, 1896.
 P. Marko, Qyteti — Qyteti i fundit, Tiranë, 1960.
 Q. Buxheli, Karjera — Karjera e zotit Maksut, Tiranë, 1971.
 Q. Bakalli, Mjekimi — Mjekimi i helmimeve dhe i disa aksidenteve, Tiranë, 1970.
 S. Godo, Zëra — Zëra nga burime të nxehta, Tiranë, 1972.
 S. Paparisto, Prometheu — Prometheu i lidhur (përkth.), Tiranë, 1950.
 V. I. Lenin, Vepra, 21 — Vepra, V. 21, Tiranë.

R é s u m é

LA FORMATION DES ADJECTIFS EN ALBANAIS CONTEMPORAIN

Si l'on analyse les adjectifs au point de vue de la formation des mots, il résulte qu'en albanais contemporain il y a des adjectifs primitifs, dérivés, formés par conversion et composés.

Le nombre des adjectifs primitifs en albanais est relativement grand dans le stade actuel. Dans ce groupe sont compris aussi ces adjectifs qui ont pénétré des langues étrangères, mais qui ne peuvent être décomposés et analysés dans leurs éléments composants.

La plus grande partie des adjectifs de l'albanais est formée par les adjectifs dérivés, et à l'intérieur de ce groupe la première place revient à ceux formés à l'aide de la suffixation, puis viennent ceux formés à l'aide de l'article prépositif et ceux à l'aide de l'article prépositif et suffixation.

Toute une suite d'adjectifs est formée au moyen de la préfixation. Une caractéristique de ce type de formation des adjectifs est la participation du thème adjectival. Les préfixes formant des adjectifs sont les suivantes: *a-*, *anti-*, *ç-*, *i-*, *im-*, *in-*, *jashtë-*, *jo-*, *kundër-*, *pro-*, *mbi-*, *mos-*, *ndër-*, *pa-*, *para-*, *për-*, *porsa-*, *prej-*, *sapo-*, *stër-*, *tej-*. De tout ceci, les préfixes *i-*, *im-*, *in-* et *kundër-* sont parfaitement improductifs et rares; les préfixes *porsa-*, *sapo-* et *prej-* n'ont commencées à être employées que peu de temps avant dans la langue littéraire, mais leur productivité suit une ligne croissante. Le préfixe le plus productif à former des adjectifs en albanais est celui *pa-*. Pourtant, on doit admettre à ce point-ci que le type *i pashkollë* «non-scolarisé» est formé par la fusion et l'emploi de l'article prépositif dans le groupe des mots préposition + nom: *pa shkollë* «sans école».

En albanais littéraire sont formés à l'aide de la suffixation uniquement des adjectifs inarticulés. Participent comme thèmes productifs à ce type de formation des thèmes nominaux, adjectivaux, verbaux et adverbiaux, mais non pas dans une mesure égale. Les suffixes formant des adjectifs sont les suivants: *ac-*, *-acak*, *-acuk*, *-ak*, *-al(-ial)*, *-an*, *-ian*, *-anik*, *-ar*, *-arak*, *-atak*, *-tar*, *-esh*, *-ëror*, *-(ë)s*, *-ësor*, *-ik*; *-iv*; *-ist*, *-njës*, *-oç*, *-or*, *-osh*, *-oz*, *-tar*, *-tor*, *-uk*, *-ush*.

Les suffixes les plus productifs dans ce type de formation de mots sont ceux *-(ë)s* et *-or*. Une partie de suffixes est rencontrée notamment dans des adjectifs pénétrés dans la langue littéraire des langues modernes (*-al*, *-ial*, *-ian*, *-ik*, *-iv*, *-ist*). La plupart des suffixes est devenue productives dans la classe des adjectifs sous l'action de l'analogie, des adjectifs formés à l'aide de la conversion des noms correspondants.

C'est à l'aide de l'article prépositif et de la suffixation à la fois qu'est formé un nombre très grand d'adjectifs. A ce type participent les suffixes: *-ë*, *-(ë)m(ë)*, *-(ë)t(ë)* et *-shëm*. Considéré au point de vue de leur production, l'ordre de ces préfixes doit être renversé: *-shëm*, *-(ë)t(ë)*, *-(ë)m(ë)*. On doit faire relever que dans les formations à suffixe *-t(ë)* on doit comprendre aussi les adjectifs dérivés de thèmes numéral, considérés jusqu'à présent comme des numéraux cardinaux.

Considérant la question de la formation des mots sur le seul plan de la langue littéraire commune, des questions sérieuses soulèvent les formations à suffixes *-(ë)s* et *-shëm*: quels thème y servent comme thèmes productifs pour les formations à thème en *-o*? L'auteur soutient, dans son exposé, l'opinion que dans ces cas sert comme thème productif le thème même du verbe, à *-o* développé en *-ue*. Compte tenu que le type à *-shëm* a une sémantique spécifique parfaitement distincte, il doit déterminer une diffusion générale et plus rapide au dépens des

adjectifs à article prépositif de l'infinitif, lorsque ces derniers sont employés au lieu des premiers, ce qui est une caractéristique propre du dialecte tosqe.

Le type le moins productif dans la formation des adjectifs est celui de la dérivation à l'aide de l'article prépositif, de la préfixation et de la suffixation. Y participent seulement le préfixe *për-* et les suffixes *-ëm*, *-të*, *-shëm*.

A l'aide de l'article prépositif sont formés tous les adjectifs de l'infinitif du verbe sans suffixe et par la fusion du groupe de mots *pa* + nom, ainsi qu'un petit nombre d'autres provenant de quelques adjectifs et adverbes.

Un type très productif, et qui n'a pas été traité jusqu'à ce jour, dans la formation des adjectifs en albanais, est celui de la conversion. C'est au moyen de ce mode que sont formés des adjectifs à partir de noms désignant l'habitant ou le citoyen d'un pays, ou bien qui désignent des individus d'après leur métier ou d'après quelque trait caractéristique propre. C'est par ce moyen que sont formés aussi quelques adjectifs à partir d'adverbes très anciens. Ce type de formation des mots reste le plus problématique dans la formation des adjectifs de la langue albanaise et exige une étude plus concentrée, du fait que, indépendamment du type général, l'histoire de chaque mot doit être suivie à part et avec soin, puisqu'elle peut faire exception à la règle, c'est-à-dire peut être formée tout d'abord comme adjectif pour passer ensuite à un nom.

Les adjectifs composés représentent, au même titre, un groupe extrêmement riche de mots. Le type à rapports coordonnés est caractéristique à la langue littéraire et a une densité particulièrement grande dans le style publicistique. Doit être biffé le tiret entre les deux éléments composants de ces composés, du fait que la fusion s'accomplit à travers la voyelle *-o-*.

Le type à rapports subordonnés a une base populaire dans la langue albanaise et connaît plusieurs sous-types, dont la première place va aux adjectifs composés par un thème nominal et un thème adjectival et les adjectifs composés par deux thèmes nominaux (*kokëmadh*; *kokëderr*). Y participent, habituellement, deux thèmes productifs, mais même lorsqu'il y a trois, en réalité deux sont soudés entre eux et subordonnés au troisième (*dor-e-këmbargjendë*, *sy-e-vetullzezë*).

Moins productives sont les formations de deux thèmes adjectivaux (*gjermano-perëndimor-*, où la fixation de l'ordre des éléments composants de la composition constitue, dans plusieurs cas, une question embarrassante), d'un thème adverbial et d'un nom ou inversement (*keqdashës*, *barkjashtë*), d'un numéral (ou pronom indéfini) et d'un nom (*njëditor*, *disavjeçar*), d'un numéral (ou pronom indéfini) et d'un nom avec le formant *-sh* (*njëkatësh*) et du pronom réfléchi *vetë* et un nom d'action ou un adjectif analogique à ce dernier (*vetëshkarkues*).

